

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

**40 VJET**

TË AKADEMISË SË SHKENCAVE  
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

**40 YEARS**  
OF THE KOSOVA ACADEMY  
OF SCIENCES AND ARTS



Prishtinë  
2015

**REDAKSIA:**

Rexhep ISMAJLI

Eqrem BASHA

Lendita Juniku-PULA



AKADEMIA E SHKENCAVE  
DHE E ARTEVE E KOSOVËS

ACADEMIA SCIENTIARUM  
ET ARTIUM KOSOVIENSIS



Prishtinë  
2015

Copyright © ASHAK

Shtypin e sponsorizoi Focus Print - Shkup.

## PËRMBAJTJA - CONTENT

Fjala e kryetarit .....	9
Note by President of the Academy .....	13
Historiku i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.....	17
The Academy of Sciences and Arts of Kosova.....	37
Kryesitë e ASHAK-ut/ Presidencies of KASA.....	41
Anëtarët e ASHAK-ut/ Members of KASA .....	51
Biografitë dhe bibliografitë e anëtarëve/ Biographies and bibliographies of the members.....	59
Botimet e ASHAK-ut/ Editions of KASA .....	379





Akademik Hivzi Islami  
Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës  
President of the Kosovo Academy of Sciences and Arts





## FJALA E KRYETARIT

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës u themelua në vitin 1975 dhe sivjet shënon një jubile të rëndësishëm. Dyzet vjet histori, që mund të mos duken shumë në jetën e akademive me traditë të gjatë, por për ne janë si katër shekuj, të përshkuar me ngritje e rënie si rezultat i zhvillimeve të gjera politike dhe shoqërore në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi. Kthesat e mëdha shoqërore, trysnitë, urrejtjet dhe represioni, deri te përpjekja për zhbërje biologjike, turbulencat që shembën shoqërinë kosovare dhe që më në fund sollën çlirimin dhe pavarësinë e shtetit më të ri në Europë, janë ngjeshur e pasqyruar në ecjen tonë, në rrugën e mundimshme për të arritur këtu ku jemi.

Shoqëria kosovare u përball me sprovat më të egra të ekzistencës, me të ligat e një sistemi çnjerëzor, kapërceu një luftë çlirimtare, me sakrificat më sublime dhe u rilind për të dëshmuar se ishte në rrugë të drejtë. Fatin e këtij rrugëtimi e pati dhe Akademia jonë, sfidat e së cilës ishin dhe mbeten të mëdha në misionin që e ka ndaj shoqërisë dhe kërkesave të saj. Ne edhe sot përballemi me mohimin shkurtpamës, me ringjalljen e memorandumeve që kërkonin zhdukjen tonë. Shembulli i propagandës kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO e dëshmoi edhe një herë këtë. Por ne jetojmë në kohën kur preokupimet e civilizimit bashkëkohor janë më të mëdha se shpirtvogëlsia urrejtëse, me dilema e brenga të shumta për të tashmen dhe të ardhmen e njerëzimit.

Duket se civilizimi është në krizë, me shumë divergjenca dhe përplasje. Popullsia me rritjen dhe përbërjen e saj, industrializimi i hovshëm, urbanizimi intensiv dhe i pakontrolluar, problemet e ushqimit, të energjisë, të resurseve natyrore, papunësia, ndotja e mjedisit, ngrohja globale, terrorizmi, migrimet dhe kriza e refugjatëve bashkë me zhvillimet e vrullshme

teknologjike, ekonomike dhe shoqërore rreth nesh dhe në botë, me presionet e proceseve të globalizimit kërkojnë angazhim dhe mobilizim pa vonesë të potencialeve shkencore e krijuese.

Roli i Akademisë mbetet i qartë dhe i pandryshueshëm para këtyre sprovave, por edhe para problemeve dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror të vendit tonë ku ato ndjehen sot dhe do të reflektohen nesër. Në këtë fazë të ndërlikuar të transicionit në të cilën gjendemi pritjet e opinionit të gjerë nga Akademia ndonjëherë janë më të mëdha se mundësitë dhe detyrat e saj. Duke mos e kuptuar këtë fakt, jo rrallë na kërkohet të luajmë rolin e analistit apo opinionistit të mediave, me prononcime *ad hoc* për çështje të ndryshme të zhvillimeve aktuale politike e shoqërore. Akademia në asnjë rast nuk mund të involvohet në diskutimet e politikës së ditës. Duke mbledhur rreth vetes shkencëtarët, ekspertët dhe elitën e krijimtarisë artistike, dijen dhe vizionin e tyre ajo mund t'i vërë në dispozicion vetëm të zhvillimit të mendimit kritik shkencor dhe artistik dhe të ofrojë zgjidhje për shumë çështje madhore të shoqërisë, por gjithnjë mbi bazë të argumenteve shkencore dhe jashtë ritmeve të ndodhive ditore.

Me vëllimin prej 0.7% të BVP (hapësira evropiane shkon drejt 3%-shit) sa ndahen për shkencë dhe hulumtime në gjithë Kosovën, është e vështirë të synohet një shoqëri e dijes dhe e zhvillimit. Në një mjedis të ngarkuar me probleme ekonomike, sociale dhe politike, duhet të gjenden rrugë përmirësimesh për investime në këtë sferë, në mënyrë që t'i afrohem më shpejt rrjetit efektiv dhe dinamik hulumtues evropian dhe procesit të njohur "Research and Development" ("Hulumtim dhe zhvillim").

Me mundësitë ekzistuese financiare dhe të kuadrove, Akademia realizoi shumë projekte shkencore dhe artistike, botoi qindra vepra nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve, organizoi tubime shkencore, konsulta, ekspozita, koncerte etj. Paralelisht me këto ajo zhvilloi një bashkëpunim të dendur ndërkombëtar jo vetëm në kuadër të asociacionit të akademive evropiane (All European Academies, ALLEA), por edhe në kontakte të drejtpërdrejta me akademitë e rajonit dhe të Europës. Njëkohësisht zhvilloi një bashkëpunim të gjerë me të gjitha institucionet e vendit dhe me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Përvjetori që po shënojmë është dhe një rast ta kujtojmë jo vetëm

rrugëtimin e këtij institucioni, të arriturat dhe sukseset, por edhe humbjet. Vetëm në këtë vit ne humbëm pesë anëtarë të çmuar që lanë një kontribut të vlefshëm në shkencë dhe art, midis tyre dhe nënkryetarin tonë. Humbjet në njerëz na kanë ndjekur hap pas hapi vitet e fundit. Por jeta dhe puna vazhdojnë tutje. Preokupimet mbeten ato të ruajtjes së parimeve dhe misionit që kësaj Akademie ia ka besuar shoqëria. Është gjithashtu rasti të mendojmë për iniciativat dhe programet e reja sipas nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit shkencor e social dhe rrjedhimisht të afirmimit të kësaj themelate më të lartë të shkencës dhe të artit para proceseve dhe sfidave shumëdimensionale akademike, shkencore dhe krijuese në planin kombëtar, europian dhe botëror. Orientimi në resurset dhe kuadrot e reja për punë shkencore hulumtuese dhe krijimtari artistike është joshës. Çdo katër vjet ne përtërijmë radhët me anëtarë të rinj duke zgjedhur më meritoret. Aktet e fundit normative që janë në procedura miratimi tashmë synojnë të zbrisim moshën e anëtarëve të rinj, me qëllim përtëritjen e kuadrit që vitet e fundit po imponohet me rezultate të rëndësishme nga fushat e ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kjo garanton të ardhmen dhe perspektivën tonë.

Hivzi Islami

Prishtinë, nëntor 2015

Kryetar i Akademisë së Shkencave  
dhe të Arteve të Kosovës



## NOTE BY PRESIDENT OF THE ACADEMY

The Kosova Academy of Sciences and Arts was founded in 1975, and this year it marks an important anniversary. Forty years, which may not be a lot for the academies with a long tradition, have been like four centuries for us, with ups and downs due to the extensive political developments in Kosova and the former Yugoslavia. Momentous social events, tensions, hatred, and repression which amounted to efforts for extermination, the turbulences that shattered the Kosovar society, and which ultimately resulted in the liberation and later independence of the youngest state in Europe, were associated with our progression all along an arduous course of coming to where we are today.

The Kosovar society has gone through difficult challenges related to its sheer survival, ordeals caused by a ruthless system, a liberation war with sublime sacrifices, and was reborn to prove that it had been on a right course. Our Academy went through the same ordeals; faced with big challenges down the road of fulfilling a mission for the society and its needs. We continue being faced with a bigoted denial, and even with the reemergence of memoranda that called for our extermination. The example of relentless propaganda against Kosova's membership of UNESCO proved this fact yet another time. But we are living at a time when the preoccupations of the modern civilization are bigger than the malice hatred, faced with many dilemmas concerning our present and our future.

It seems that the civilization is in a crisis, with many divergences and clashes. The ever-growing population, rampant industrialization, the problems of food, energy, and natural resources, unemployment, pollution, global warming, terrorism, migration and refugee crises,

along with the rapid technological, economic, and social developments around us and worldwide, coupled with globalization processes, require instant engagement and mobilization of the scientific and creative resources.

The role of the Academy remains clear and unchanged in face of all these challenges and problems but also in the light of overall developments in our country which are felt today and will impact the future. In this complex phase of transition that we are going through, expectations of the public sometime surpass the Academy's duties and capacities. Due to the failure to understand this fact, we have quite often been called to play the role of analysts or reviewers of the media, to come up with *ad hoc* statements on different matters related pertaining to the current political or social developments. The Academy cannot become involved in the daily political debates. Assembling scientists, experts, and elite of art creators, the Academy can put their erudition and vision at the service of developing judgmental scientific and artistic opinions and to offer solutions to major problems of the society, based excessively on the scientific arguments, beyond the daily occurrences.

With a 0.7 per cent of the country's GDP (the European average being around 3%) which is allocated to the science and research at the Kosovar national level, it is unrealistic to aspire a society of knowledge and development. In an environment loaded by economic, social, and political problems, one has to find ways of boosting the investments in this field in order to be able to move closer to the efficient and dynamic European research and development network.

With the existing financial and human resources, the Academy has accomplished many scientific and artistic projects, has published hundreds of books from different fields of science and arts, has organized scientific forums, consultations, exhibitions, concerts, and other activities. Concurrently, it has focused on intensive international cooperation, not only as part of the European association of academies (All European Academies, ALLEA), but also through direct contacts with the academies of the region and Europe. At the same time, it has

cooperated closely with all institutions in the country and the Academy of Sciences of Albania.

This anniversary is a good occasion to not only recap the journey that this institution has passed, its achievements and successes, but also to remember those who are no longer among us. This year, we lost five esteemed members of our Academy who made valuable contributions to the science and arts, one of them being our vice-president. We have lost many other colleagues over past years. Yet, the life and the work go on. Our outstanding preoccupation remains upholding the principles and the mission that have been entrusted to us by the society. This is also an occasion to think about the new initiatives and programs, the needs and priorities of the social and scientific development, and correspondingly the promotion of this highest institution of science and art in the face of multidimensional academic, scientific, and artistic challenges at the national, European, and world domains. Getting new resources and new cadre for scientific research and art can always be tempting. Every four years we refresh our ranks with new members, by electing the most meritorious ones. The legal framework which is in the process of being promulgated envisages a lower age-threshold for admitting new members in order to bring in people who over the past years have achieved important results in different fields of sciences and arts. This is a guarantee for our future.

Hivzi Islami

Prishtina, November 2015

President

Kosova Academy of Sciences and Arts





# HISTORIKU I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Historia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës i shpreh zhvillimet e tërësishme ndër shqiptarë në gjysmën e dytë të sh. XX. Derisa në Shqipëri themelimi i një institucioni të këtij lloji të shkencës qe shtruar qysh para Luftës II Botërore, madje qenë ndërmarrë hapa, që u ndërpre në gjatë Luftës, dhe rifilluan pastaj, por arritën të përligjeshin vetëm pas gjallërimit të një jete universitare prej disa dekadash më 1972, në Kosovë ideja e tillë ka një histori tjetër.

Siç është shënuar te *Kosova, Vështrim monografik*, fillimet e këtyre interesimeve të organizuara lidhen me shkollimin laik dhe me zhvillimet e sh. XX. Pas Luftës II Botërore, janë vërejtur faza të ndryshme në varësi nga zhvillimet shoqërore-politike. Në fushën e statusit të Kosovës dhe të shqiptarëve në periudhën e Jugosllavisë socialiste shënohen ndryshimet në statusin e Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë (1946-1963), të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës dhe Metohisë (1963-1968) dhe të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës (1968-1990).

Fazën I (1945-1966) e karakterizojnë zhvillime konfuze dhe nisma të lëna në rrugë. Ndërmerren disa veprimtari të natyrës praktike, diçka në kuadër të Muzeut të Kosovës. Sprova që duket se mund të bëhej e suksesshme me Institutin Albanologjik (1953) u ndërpre pas 2 vjetësh (1955), ndërsa në fazën e fundit të trysnisë së mbledhjes së armëve dhe shpërnguljes për Turqi (1958-59), u themeluan Shkolla e Naltë Administrative dhe Shkolla e Naltë Pedagogjike në Prishtinë, natyrisht, me mbisundim të serbishtes. Klima e tillë do të vazhdonte deri më 1966 (kohë brenda së cilës u themeluan Fakulteti Filozofik, 1960, Fakulteti Juridik-Ekonomik, 1961, si degë të Universitetit të Beogradit, me mësim serbisht, përveç në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe). Fazën II (1967-1980) e karakterizojnë, jo vetëm kërkesat e shtuara në fushën e arsimit në gjuhën shqipe, në fushën e veprimtarisë hulumtuese-shkencore, po edhe degëzimi i rrjetit të institucioneve shkencore-hulumtuese deri tek Akademia e

Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, themelimi i Bashkësisë Krahinore për Veprimtari Shkencore. Fazën III (1981-1990) e karakterizojnë trysnitë e përgjithshme ndaj institucioneve shkencore dhe arsimore të Kosovës, kritikrat për zhvillimin e tyre në drejtim të realitetit kosovar dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Përveç punës së zakonshme profesionale-shkencore, këto institucione dhe studiuesit që vepronin brenda tyre u ballafaquan dhe me nevojën evidente për të bërë përpjekje për ruajtjen e institucioneve, për mbijetesë.

Faza IV, pas vitit 1990, karakterizohet me aneksimin e Kosovës nga Serbia, largimin e shqiptarëve nga institucionet arsimore-shkencore, ndërprerjen e financimit për institucionet e pavarura të shkencës, shuarjen e institucioneve shkencore-hulumtuese që vepronin në kuadër të ekonomisë për shkak të rrëgjimit dhe plaçkitjeve, etj. Në këtë fazë të qëndresës paqësore dhe të luftës për jetësimin e pavarësisë së Kosovës të shpallur shtet i pavarur (1991), vijoi mbajtja gjallë e shkollimit universitar në tërë sistemin paralel dhe jashtë mjediseve universitare, që kishte okupuar shteti i Serbisë, riorganizimi në rrethana të reja i institucioneve (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë i Kosovës, Instituti Ekonomik) për mbijetesë.

Fazën V, pas vitit 2000, e karakterizojnë zhvillime relativisht pak të organizuara. Kishin mbijetuar Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë i Kosovës, Instituti Ekonomik dhe Universiteti, por jo institutet e veçanta brenda tij. Në fazën 2000-2003 çdo gjë u përqendrua te drejtimi ndërkombëtar, që kishte përparësi të tjera. Institucionet e përmendura vijuan punën e tyre gjithnjë në rrethana emergjente. Pas vitit 2004 veprimtaria e institucioneve të pavarura shkencore (përfshirë Akademinë) u vu nën ombrellën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë. Vetëm pas 2004 u bënë të mundshme rregulime ligjore që rikthyen veçimin e Akademisë si agjenci të veçantë buxhetore. Më 2003 Ministria e Kulturës themeloi *Institutin e Arkeologjisë*, ndërsa nismat private shënuan suksese në organizimin e institucioneve që merren edhe me veprimtari hulumtuese shkencore. Në vijim kemi dhe fenomenin e themelimit të institucioneve universitare private.

Në vitin 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës themeloi *Këshillin Kombëtar për Shkencë*, detyra e parë e të cilit ishte hartimi i një strategjie të zhvillimit shkencor në pesëvjeçarin e ardhshëm. Ligji për Veprimtari Shkencore i Kosovës i miratuar ndërkohë saktësonte që për veprimtaritë hulumtuese-shkencore të sigurohej masa prej 0,7% e buxhetit të vendit, por

mënyra e vënies në veprim të kësaj mase buxhetore ende nuk ka gjetur rrugë të përshtatshme. Institucionet e pavarura të shkencës (ASHAK, IAP, IHK, IA) mbahen ende me buxhet për shpenzimet administrative dhe pjesërisht në funksion të programeve më të gjera hulumtuese.

Në vitet '50 të sh. XX në Kosovë nisi të shtrohej nevoja për studime dhe hulumtime shkencore të organizuara të nivelit më të lartë, kështu që më 1953 u themelua Instituti Albanologjik, i cili, në rrethanat e atëhershme të trysnisë së egër ndaj shqiptarëve arriti të vepronte vetëm deri më 1955, kur pushteti e mbylli me pretekstin e shpjeguar nga udhëheqësi partiak malazias i Kosovës Dušan Mugoša në një mbledhje të atëhershme si vijon: “Atë institut ne e kemi formuar në kohën e tensionit informbyroist, ndër të tjera që t’i kundërvihemi propagandës së tyre të Shqipërisë, kurse sot ai nuk është i nevojshëm si i tillë. Sepse ne shumicën e gjërave të fushave, të cilat i studion Instituti, mund t’i marrim drejtpërdrejt nga Shqipëria kur të duam”.

Megjithatë, kjo logjikë nuk mundi të mbyllte çdo shteg. Kështu u themelua Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, fill pastaj Fakulteti Filozofik dhe Fakulteti Juridik-Ekonomik, si filiala të Universitetit të Beogradit dhe me mësimdhënie serbokroatisht. Fakti që këto institucione e zhvillonin veprimtarinë e tyre në mjedis kosovar krijoi mundësinë që një numër gjithnjë e më i madh i të rinjve shqiptarë të inkuadrohej në këto veprimtari dhe me rastin e ndryshimit të parë të klimës politike në vend më 1966 të delte me kërkesa normale për mësimdhënie në gjuhën shqipe dhe zgjerim të rrjetit të institucioneve universitare sipas përmasave të vendit. Kjo solli me vete dhe hapësirën për zhvillimin e veprimtarive shkencore-hulumtuese në këtë mjedis dhe në gjuhën shqipe. Më 1967 u themelua sërish Instituti Albanologjik, u intensifikua puna në Institutin e Historisë dhe në institucionet e tjera shkencore-kulturore si Muzeu i Kosovës, Arkivi, etj. Në bërthamat universitare të studimeve në fushat e shkencave të natyrës dhe teknike tashmë ekzistonte një interes dhe veprimtari hulumtuese-shkencore, ndërsa fryma e re dhe entuziazmi i dhanë krih shprehjes së nevojave jo vetëm për zgjerim të tyre, po edhe për botim të rezultateve të kësaj pune. Kështu iu dha një shtysë revistave të specializuara në fusha të dijes, si *Gjurmime albanologjike* (në fillim, 1962-1968, në Fakultetin e Filozofisë, Dega e Gjuhës Shqipe, më vonë në Institutin Albanologjik), ndërsa një vend me peshë në këtë hapësirë e zunë dhe nismat e studentëve, si ajo me revistën shkencore *Dituria* (1971), ndërsa po vazhdonte botimi i intensifikuar i revistës me spektër më të gjerë *Përparimi* (nga 1955). Zgjerimi i rrjetit të fakulteteve dhe të katedrave brenda tyre, themelimi i

Fakultetit të Mjekësisë dhe i Fakultetit Teknik, rezultuan me themelimin e Universitetit të Prishtinës, në kuadër të të cilit u arrit një shkallë e lartë e veprimtarive universitare dhe shkencore-hulumtuese, ndërsa zhvillimet në fushën e ekonomisë, sidomos në kuadër të komplekseve Trepça, Elektroekonomia e Kosovës, Kombinati Agro-industrial, sistemi bankar, etj. i dhanë një përshpejtim plotësues kësaj veprimtarie të gjithmbarshme. Kështu, ekonomia jo e fuqishme, por në rritje, bëhej gjithnjë e më shumë mbështetje për zgjerimin e potencialit shkencor-hulumtues, i cili më vonë do të bëhej bartës i zhvillimeve të përgjithshme në vend. Të gjitha këto mbështeteshin nga një buxhet i veçantë për veprimtarinë shkencore.

Në fillim të viteve '70, fare natyrshëm dhe paralelisht me kërkesat për mëvetësimin e Kosovës në rrafsh të barabartë me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë, u shtrua nevoja për krijimin e institucionit më të lartë të shkencës dhe të arteve. Në përgjigje të saj Kuvendi i Kosovës më 1974 ngriti Komisionin Amë për themelimin e Shoqatës së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, sipas uzuseve që ishin vënë në përdorim në Republikat e tjera të Jugosllavisë dhe në Vojvodinë. Brenda muajit tetor 1975 Komisioni zgjodhi 11 anëtarë të rregullt dhe 2 korrespondentë të Shoqatës, ndërsa më 20 dhjetor të atij viti u themeluan organet e saj. Brenda tre vjetësh pune, kjo Shoqatë u transformua në Akademi të Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Këtë transformim Kuvendi i Kosovës e sanksionoi me Ligjin mbi themelimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 18 prill 1978. Në fjalën përshëndetëse të Kryetarit të parë të ShShK-së, Esad Mekulit, ky akt i themelimit çmohej si “njëra nga fitoret më të rëndësishme, me vlerë të përhershme historike”.<sup>1</sup>

Më 30 dhjetor 1974, në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kryetari i Kuvendit Iljaz Kurtersh i nxori Dekretin nr. 011-96 për shpalljen e Ligjit mbi themelimin e Shoqatës së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ligji ka hyrë në fuqi me shpalljen e tij në *Gazetën zyrtare të KSAK numër 43/74*, ndërsa më 6 mars 1975, në bazë të nenit 311 të Kushtetutës së Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, Kuvendi, në Dhomën e tij të Punës së Bashkuar, mori vendimin *Mbi emërimin e Komisionit të themelimit të Shoqatës së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës* me këtë përbërje: D. Kanazir, Kryetar; D. Rozhaja, Sekretar; P.

<sup>1</sup> Shih Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Vjetari-Godišnjak 1*, 1976, Prishtinë, f. 3.

Vranicki, D. Nedeljković, J. Milčinski, A. Benac, M. Apostolski, D. Ivanović, I. Ajeti, A. Hadri, V. Filipović, E. Mekuli, A. Topalović, R. Qosja, dhe S. Pupovci. Në emër të Kuvendit Vendimin e kishin nënshkruar Kryetari i tij Iljaz Kurteshi dhe Kryetari i Dhomës së Punës së Bashkuar të Kuvendit - Adem Hashani. Më 17 maj 1975 u mbajt mbledhja e parë e Komisionit të themelimit të ShShAK-së nën drejtimin e D. Rozhajës. Në mbledhje merrnin pjesë: M. Apostolski, D. Ivanović, I. Ajeti, A. Hadri, S. Pupovci, V. Filipović, E. Mekuli, R. Qosja dhe A. Topalović, si dhe P. Nushi, nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSAK-së, F. Sylja, sekretar i Sekretariatit Krahinor të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës, M. Vuksanović, sekretar i Bashkësisë Krahinore të Punës Shkencore dhe Z. Shehu, sekretar i përgjithshëm i Universitetit.

Sipas Ligjit mbi Themelimin e Shoqatës së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës parashihej që propozime për zgjedhjen e anëtarëve të ShShAK-së mund të bënin: Universiteti i Prishtinës, fakultetet, Akademia e Arteve, institucionet shkencore dhe Bashkësia e Institucioneve Shkencore të Kosovës. Propozimet pranoheshin deri më 25 qershor 1975 (mbledhja u mbajt më 17 maj). Kërkohej dhe pëlqimi i të propozuarit. Kriteret ishin ato që qenë shpallur përgjithësisht në ligjet dhe statutet e akademive të Jugosllavisë dhe të Shoqatës së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi. Mbaheshin parasysh specifikat vendore. Në mbledhjen e tretë të Komisionit të themelimit të SHSHK-së më 7 tetor 1975 u zgjodhën 11 anëtarë të rregullt dhe 2 anëtarë korrespondentë të Shoqatës: të rregullt: A. Hadri, shkencat historike; D. Rozhaja, shkencat biologjike; E. Mekuli, letërsi; I. Ajeti, linguistikë; R. Qosja, letërsi; S. Pupovci, shkencat juridike; V. Filipović, shkencat mbi letërsinë; B. Hrabak, shkencat historike; G. Zajmi, shkencat juridike-politike; J. Rexhepagiq, shkencat pedagogjike; Lj. Rakić, shkencat bio-medicinale; anëtarë korrespondentë: M. Dushi, shkencat teknike; M. Karaman, shkencat biologjike. Mbledhja e parë e Kuvendit të Shoqatës u mbajt më 29 dhjetor 1975. Në të u bë zgjedhja e udhëheqjes së Shoqatës: Kryetar E. Mekuli, nënkryetarë: I. Ajeti dhe V. Filipović, sekretar J. Rexhepagiq.

Përzgjedhja e anëtarëve të parë cilësohet nga disa momente: anëtarët e zgjedhur kanë votuar për veten (7 prej 8 anëtarëve të Komisionit themelues); anëtarët e rinj janë zgjedhur drejtpërsëdrejti *anëtarë të rregullt (akademikë)*; në mbledhje kanë qenë të pranishme institucionet e pushtetit ekzekutiv të Kosovës. Më vonë zgjedhjet kanë kaluar nëpër procedurën vijuese akademike: çdo anëtar i ri mund të zgjidhet për herë të parë vetëm *anëtar korres-*

*pondent*, ndërsa më vonë mund të propozohet për avancim në *anëtar të rregullt* (korrespondentët nuk kanë të drejtë të votojnë për zgjedhje të anëtarëve të rregullt); propozimet bëhen me rrugë ligjore të institucioneve që kanë të drejtë kandidimi; Seksionet dhe Kuvendi, sipas një procedure ligjore, marrin në shqyrtim diskutimin publik të vlerësimeve për kandidatët dhe mundësinë e mbështetjes/ objeksioneve publike për ta, shqyrtimin e propozimeve burimore, të recensimeve të brendshme për çdo kandidat veç e veç, të reagimeve eventuale publike dhe të diskutimeve në Seksione; vendimin përfundimtar e merr gjithnjë Kuvendi i Akademisë me vota të fshehta; asnjë prej anëtarëve korrespondentë apo të rregullt nuk ka të drejtë të kandidojë apo ta propozojë veten për zgjedhje, apo për avancim; anëtarët e Akademisë i shtrohen një procedure votimi, korrespondentët në Seksion dhe në Kuvend, të rregulltit edhe një herë në Seksion dhe në Kuvend.

Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës më 1978 u rrit në Akademi. Gjendja në seksionet në vitin 1978 ishte ajo e kohës së themelimit: Seksionin e Shkencave Shoqërore e përbënin: akademikët A. Hadri, B. Hrabak, G. Zajmi, J. Rexhepagiq dhe S. Pupovci; Seksionin e Shkencave të Natyrës: akademikët D. Rozhaja, E. Mekuli, Lj. Rakić, anëtarët korrespondentë M. Dushi dhe M. Karaman; Seksionin e Gjuhësisë, të Letërsisë dhe të Arteve e përbënin: akademikët I. Ajeti, R. Qosja dhe V. Filipović. Atëherë Shoqata/ Akademia kishte dhe kategorinë *Anëtar i brendshëm jashtë përbërjes së trupit të punës* dhe më 1976 të tillë ishin zgjedhur: akademikët B. Pavićević, D. Ivanović, D. Kanazir, E. Čamo, G. Novak, J. Milčinski, M. Apostolski dhe P. Savić. Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës u rrit në Akademi të Shkencave dhe të Arteve të Kosovës me vendim të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar dhe të Kuvendit të Bashkësisë Krahinore Vetëqeverisëse të Interesit të Punës Shkencore të datës 18 prill 1978, në të cilën, në bazë të propozimit të Shoqatës, u miratua Ligji mbi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.<sup>2</sup>

Në Fjalën e akademik Mekulit, ndër të tjera, thuhej: “Qysh gjatë përgatitjeve për formimin e këtij institucioni më të lartë shkencor dhe artistik në Krahinë, kishte dilema rreth emrit të saj. Me gjithë që, më në fund, u vendos të emërohet Shoqatë – ajo u organizua në parimet e akademive: zgjedhja e anëtarëve të parë u bë nga komisioni përkatës, i përbërë nga shkencëtarë tanë e të vendit, sipas kritereve që përdoren për zgjedhjet e

<sup>2</sup> **Vjetari - Godišnjak** 2, 1978, f. 7. **Ligji** u botua në **Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës** nr. 24/78.

anëtarëve në të gjitha akademitë tona; sipas planprogrameve dhe detyrave shkencore dhe artistike – kuptohet në përpjesëtime më të vogla, përse në fillim të punës – Shoqata jonë as që dallohej nga akademitë e tjera të shkencave dhe të arteve”. “... Në fund të vitit 1976, siç u tha edhe në ekspozenë, Shoqata u pranua anëtare e Këshillit të Akademive të Shkencave dhe të Arteve të Jugosllavisë dhe, kështu, edhe formalisht u barazua me akademitë e tjera të vendit.” Dekretin e Kuvendit të Kosovës numër 612-1/78 të datës 18 prill 1978 për shpalljen e Ligjit mbi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e ka firmosur Kryetari i Kuvendit, Iljaz Kurteshi.

Shoqata u rrit në Akademi me po ata anëtarë që ishin zgjedhur në fillim. Ata që më 1976 klasifikoheshin në kategorinë ‘*anëtarë të brëndshëm jashtë përbërjes së trupit të punës*’, më 1979 do të quhen ‘*anëtarë jashtë përbërjes së trupit të punës*’, ndërsa tani do të ketë edhe *anëtarë nderi*.

Veprimtarinë e vet ASHAK-u duhej ta zhvillonte në rrethana të ekzistencës së një universiteti në rritje, brenda të cilit vepronin institute e bërtama shkencore dhe hulumtuese, të ekzistencës së disa instituteve të pavarura, apo të instituteve që vepronin në kuadër ose të lidhura me kapacitetet industriale të Kosovës, ashtu si dhe të institucioneve të tjera me interes në këto fusha. Në ato rrethana ASHAK-u duhej ta formësonte veprimtarinë e vet si institucioni më i lartë i shkencave dhe i arteve dhe të merrte role të rëndësishme në fushat e shkencave dhe të arteve në suaza të organizimit shoqëror-shtetëror të Kosovës brenda Federatës së Jugosllavisë. ASHAK-u duhej ta harmonizonte veprimtarinë e vet me Unionin e Akademive të Jugosllavisë, ku bënte pjesë si anëtare e barabartë dhe në një mandat (1985-1987) që Kryesuese e Unionit dhe Prishtina qendër e selisë së tij. Përmes atij Unioni ASHAK-u e zhvillonte veprimtarinë ndërkombëtare.

Më 1976 Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës nisi botimet e para periodike: *Vjetari-Godišnjak*, që me këtë titull do të vazhdojë të dalë deri më 1991, kur duhet të jetë botuar vëllimi 11-12; dhe në kuadër të Seksionit të Shkencave të Natyrës: *Acta biologiae et medicinae experimentalis* (këtë bashkë me Shoqatën për Biologji dhe Mjekësi Eksperimentale të Kosovës), që do të vazhdojë të dalë me rregull deri më 1989. Në vitin 1977 Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës arriti të botonte dhe një *Libër shënues – Spomenica*. Në vitin 1978 Seksioni i Shkencave të Natyrës nxori botimin e parë të veçantë – Lj. Rakić: *Regulacioni sistemi ponašanja*. Po atë vit Shoqata u shndërrua në Akademi.

Në vitin 1979 Akademia vazhdoi botimin e veprave të veçanta. Të

tri seksionet nxorën nga një botim: vëllimin me studime të R. Qosjes *Prej tipologjisë deri te periodizimi shqip* (bashkë me Institutin Albanologjik), vëllimin *Tito për Kosovën, Kosova për Titon*, shqip e serbokroatisht dhe vëllimin e përbashkët *Bronhijalni reaktivitet*, serbokroatisht, ndërsa monografinë e J. Redžepagić-it *Pedagoška misao Svetozara Markovića* bashkë me/ dhe në kuadër të botimeve të veçanta të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve. Në vitin 1980 Seksioni i Shkencave Shoqërore nisi botimin e përkohshëm *Studime-Studije*, libri 1, ndërsa dy librat e tjerë u botuan respektivisht më 1983 dhe më 1988. Më 1980 nisi dhe botimi i serisë *Kërkime – Istraživanja* të Seksionit të Shkencave të Natyrës, që do të vazhdojë të dalë më 1984 (libri 2), 1985 (libri 3) dhe 1986 (libri 4). Seksioni i Gjuhësisë, i Letërsisë dhe i Arteve atë vit botoi monografinë e B. Bokshit *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes* dhe të V. Filipović-it *Umetnost Veljka Petrovića*.

Në vitin 1981 Seksioni i Shkencave Shoqërore nisi botimin *Kërkime-Istraživanja*, prej të cilit dolën vetëm 2 vëllime atë vit, ndërsa ASHAK-u përgatiti për shtyp materialet e Konferencës shkencore për 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në dy vëllime, që arriti të botohej vetëm më 1990. Më 1982 ky Seksion dhe Seksioni i Gjuhësisë, i Letërsisë dhe i Arteve botuan nga një vepër të veçantë të autorëve G. Zajmi dhe I. Ajeti në gjuhën serbokroate.

Më 1983 Seksioni i Gjuhësisë, i Letërsisë dhe i Arteve arriti të botonte një vepër të veçantë – *Književni ogledi i studije* të V. Vuković. Në vitin 1984 Seksioni i Shkencave Shoqërore arriti të botonte veprat e M. Krasniqit – *Lugu i Baranit*, shqip, të A. Hadrit – *Ali Keljendi*, serbokroatisht, dhe vëllimin e përbashkët – *Aktualiteti dhe rëndësia e mendimit dhe veprimtarisë praktike të Marksit*, shqip e serbo-kroatisht, ndërsa Seksioni i Gjuhësisë, i Letërsisë dhe i Arteve veprën e V. Bovan, *Srpske narodne umotvorine sa Kosova*.

Më 1985 seksionet nuk botuan asnjë vepër të veçantë, ndërsa ASHAK-u botoi librin *ASHAK-ANUK 1975-1985*. Në vitin 1986 u botuan 3 vepra të veçanta serbokroatisht: J. Redžepagić: *Od gradjanske do marksističko-lenjinističke pedagogije*, D. Bajraktarević: *Istorijski razvoj kosovsko-metohijskih govora* dhe M. Haxhiu & V. Moračić-Piperski: *Centralni hemosenzorni sistem i respirativna aktivnost*.

Po kështu më 1987 Seksioni i Shkencave Shoqërore arriti të botonte veprën kolektive monografike *Rugova*. Vitin 1988 e karakterizoi e njëjta



frymë. U botuan veprat kolektive *Život i delo Vuka Karadžića* (serbokroatisht) dhe *Efikasiteti i zhvillimit të viseve më pak të zhvilluara të Jugosllavisë* (serbokroatisht e shqip) dhe vepra e D. Pejčinović-it: *Ekološka studija korovske vegetacije Kosova*, ndërsa në vitin 1989 nuk doli asnjë botim i veçantë.

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës kishte vendosur që si datë e themelimit të Akademisë të jetë data kur u vendos të themelohej Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, pra viti 1975. Për dhjetëvjetorin e themelimit të Akademisë u nxor botimi luksoz: *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Akademija nauka i umetnosti Kosova*, Prishtinë – Priština, 1985, ff. 235.

Deri më 1989 Akademia kishte tri Seksione: 1. Seksionin e Shkencave Shoqërore, 2. Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe 3. Seksionin e Gjuhësisë, të Letërsisë dhe të Arteve. Më 1985 Kuvendi i ASHAK-ut mori vendim për themelimin e Arkivit të Akademisë e të Institutit të Arkeologjisë dhe të Etnografisë. Arkivi dhe Biblioteka, që ishin funksionalizuar, u shkatërruan pas ndërhyrjes së policisë serbe në selinë e Akademisë më 1994, çka pamundësoi punën e saj më tej në atë godinë. Instituti i Arkeologjisë dhe i Etnografisë nuk arriti të themelohej për shkak të trysnive politike dhe tendencave drejt rrëgjimit të Akademisë pas vitit 1985 dhe për arsye edhe buxhetore më vonë.

Ajo fazë, që zgjati deri në fund të viteve '80, karakterizohej me një synim të përhershëm të zhvillimit institucional të ASHAK-ut në rrjedhat e zakonshme për një akademi në atë kohë. Kufizimet buxhetore, por edhe trysnitë jashtëshkencore që sa vinin e shtoheshin, nuk e linin ASHAK-un të zhvillohej me rrugë normale. Është e qartë se vullneti i anëtarëve bënte dhe diçka më shumë se ç' lejonin rrethanat.

Në të vërtetë, tendencat e tilla të mbushjes së veprimtarisë së kësaj akademie me botime më shpesh serbokroatisht apo në të dy gjuhët erdhën e u forcuan drejt mbytyjes së plotë të veprimtarisë botuese të institucionit më të lartë të shkencave dhe të arteve në Kosovë. Më 1989 filloi faza e përgjithshme e përshkallëzimit të trysnisë dhe agresionit të institucioneve shtetërore të Serbisë ndaj institucioneve të Kosovës. Duke përdorur dhe mekanizmat jugosllavë të detyrimit, Serbia aneksoi Kosovën dhe nisi procesin e reduktimit drastik apo të shuarjes së të gjitha institucioneve që shënonin mëvetësinë dhe shtetësinë e Kosovës, të institucioneve që vepronin drejtpërsëdrejti për emancipimin, edukimin dhe përgatitjen e popullatës

për zhvillim të mëtejshëm. Në këtë proces u godit së pari Universiteti i Prishtinës, në të cilin më 1991 u pamundësua mësimdhënia në gjuhën shqipe dhe u nxorën nga puna 840 profesorë dhe arsimtarë në një muaj. Një numër i mirë i akademikëve, intelektualëve, profesorëve të universitetit, studiuesve, shkrimtarëve, gazetarëve dhe veprimtarëve të tjerë të kulturës e të dijes nuk u pajtua me gjendjen dhe u vu në rrjedhën e rezistencës në format më të ndryshme.

Qysh në diskutimet për ndryshimet kushtetuese të vitit 1989 Kuvendi i ASHAK-ut doli me angazhimet publike së pari me *Deklaratën Kushtetuese*, pastaj me angazhimet dhe veprimtaritë e tjera në favor të mbrojtjes së të drejtave që po shkeleshin në mënyrë drastike. Përveç angazhimit bashkë me mekanizmat e tjerë të rezistencës në drejtim të organizimit të *Referendumit për pavarësi*, në drejtim të organizimit e të hartimit të dokumenteve themelore për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, ASHAK-u në atë kohë zhvilloi dhe veprimtari shkencore për afirmimin e çështjes së drejtë, sidomos me simpoziumet e mëdha shkencore me karakter ndërkombëtar – “Shqiptarët dhe Evropa” në Prishtinë (materialet nuk u botuan kurrë) dhe “Çështja shqiptare” bashkë me Akademinë e Shqipërisë në Tiranë (u botuan nga Instituti i Historisë), dy simpoziumet për “Gjenocidin serb në Kosovë”, simpoziumet për “Statusin e Kosovës”, më vonë “Strategjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës”, ashtu si dhe një varg takimesh e konferencash për fusha të ndryshme të dijes, materialet e të cilave janë botuar.

Kështu më 1990 Akademia botoi vetëm veprën e Z. Grudës “Panamski kanal” dhe ribotoi veprën e Gj. Fishtës “Anzat e Parnasit”, ndërsa më 1991 vetëm veprën e D. Petrović-it: “Književni rad Gligorija Camblaka u Srbiji”. Pastaj vijuan dy vjet pa asnjë botim.

Më 1992 Kuvendi i Serbisë, përmes Ligjit për Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, e shpalli të mbyllur ASHAK-un dhe urdhëroi që pasuria e Akademisë të merrej nga establishmenti ekzekutiv i instaluar i Kosovës. Anëtarët e ASHAK-ut nuk e përfillën atë vendim dhe, në vijim të një deklarimi me shkrim, vazhduan punën e tyre. Më 1994 policia serbe mbylli godinën e ASHAK-ut, përzuri prej andej akademikët dhe e përdori pastaj atë për destinacion tjetër. ASHAK-u u detyrua që veprimtarinë e vet ta zhvillonte në një shtëpi që ia kishte dhënë në dispozicion pa kundërshpërblim profesori i universitetit dr. Hamdi Sylja në lagjen Ulpiana në Prishtinë.

Kjo qe fazë e re e veprimtarisë së Akademisë në rrethana skajshmërisht të vështira. ASHAK-u nuk u pajtua me ndalimin e botimeve shkencore dhe as me pushimin e kontakteve ndërkombëtare dhe si rrugë të mbijetesës e të rezistencës zgjodhi zgjerimin e veprimtarisë. Në atë kohë në Kosovë vepronin vetëm pak anëtarë të ASHAK-ut – mjekët M. Haxhiu, O. Imami, studiuesi i fushave të bujqësisë R. Bakalli, kishin mërguar në Amerikë, historiani Z. Mirdita në Zagreb, disa të tjerë nuk ishin më në këtë jetë (kështu ASHAK-u mbeti pa mjekë e historianë). Zgjedhjet e fundit të vitit 1993 sollën mundësinë që në vitin 1994 të niste ringjallja e Akademisë. Në vitet 1990-93 ASHAK-u kishte botuar vetëm doktoratën e D. Petrović-it “Književni rad Gligorija Camblaka u Srbiji” (pa interes për Kosovën) më 1991. Menjëherë më 1994 u botuan veprat e I. Ajetit, “Shqiptarët dhe gjuha e tyre” dhe të G. Zajmit “Dimensions of the Question of Kosova in the Balkans”, po më 1994 u krijua Seksioni i Arteve i veçantë nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, u themelua revista për shkencat shoqërore e filologjike *Studime*. Me gjithë vështirësitë materiale-teknike, por edhe të tjera, pas kontakteve me autorë të mundshëm dhe pas komunikimit dhe me studiues jashtë Kosovës, të cilët e respektonin vullnetin e anëtarëve të ASHAK-ut u nxor numri 1 me të gjitha kriteret për një revistë të këtij lloji, me rezymetë në gjuhët me qarkullim të gjerë; me platformën dhe me konturnat e krijuara revista vazhdon të dalë me rregull deri në ditët tona dhe boton edhe në gjuhët me qarkullim ndërkombëtar.

Vitet 1995-1996 shënojnë rritjen në drejtim të kësaj kthese për mbarë në botimet dhe veprimtarinë e ASHAK-ut. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë botoi librin përkujtimor për E. Mekulin dhe nisi projektin afatgjatë me serinë e veprave të albanologëve të shquar të traditës me vëllimin I të *Veprave* të S. Rizës, ndërsa Seksioni i Shkencave Shoqërore botoi veprën kolektive “Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza lindore e këndeje” dhe veprën e J. Rexhepagiqit: “Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes kombëtare”. Seksioni i Shkencave të Natyrës e rinisi ciklin e botimeve të veçanta me veprat kolektive: “Shqyrtim multidisiplinor i mundësive zhvillimore të Kosovës”. Këto zgjerime shkojnë paralelisht me rritjen e numrit të anëtarëve të ASHAK-ut. Në vitet 1997 dhe 1998 u çuan më tej nismat e mëparme. Vazhdoi botimi i revistës *Studime* dhe nisi botimi i revistës *Kërkime* (shkencat e natyrës), që vijon me rregull edhe sot; u botua vëllimi 2 i *Veprave* të S. Rizës, vëllimi 1 i *Veprave* të I. Ajetit dhe të G. Zajmit, opera *Goca e Kaçanikut* e R. Dho-

mit, vëllimet 2 dhe 3 të *Veprave* të I. Ajetit, monografia e B. Bokshit *Pjesorja e shqipës*, materialet e konferencës *Letërsia shqipe dhe gjuha letrare* dhe në Seksionin e Shkencave të Natyrës veprat e N. Dacit *Kimia organike eksperimentale* (bashkë me Librin Shkollor) dhe *Kimia e mjedisit*.

Zgjerimi i rezistencës së armatosur ndaj pushtimit serb më 1998 dhe lufta e vitit 1999 zvogëluan përkohësisht punën e ASHAK-ut, por anëtarët e saj qenë aktivë me veprimtari. Arriti të botohej numri i ri i revistës *Kërkime* dhe monografia e M. Dushit *Sistemet ciklike të transportit*. Faza e re në jetën e ASHAK-ut filloi pas Luftës së vitit 1999, pas kthimit të popullatës së dëbuar në rrethana të rrënimimit të tërësishëm të vendit. ASHAK-u u kthye në selinë e vet dhe vazhdoi punën me intensitet më të madh. Pas revistave, në vitin 2000 u nxorën dhe botimet e veçanta: L. Gjergji: *Nëna e Dashurisë* (Kryesia), Naim Frashëri – *100 vjet pas*, D. Rozhaja: *Fiziologjia krahasuese* (SSHN) dhe H. Muharremi: *Muslim Mulliqi* (SA). Këto rrjedha vijnë e shtohen në vitin 2001 me botimet e Ajetit, Zajmit, Gjerqekut, Dhomit, Ballatës, Ferrit dhe me botimet kolektive, ashtu si më 2002 me veprat e Rizës, Ajetit, Dacit, Dushit, Gashit-Spahos, Dhomit etj. Në këtë periudhë pati dhe diskutime brenda Akademisë për të ardhmen e saj. Puna vijoi me përqëndrime në aspektet e mundshme në rrethanat e mungesave të mjedisit dhe të burimeve buxhetore të reduktuar, pra kryesisht në botimet (më shpesh nga donacionet).

Në vitin 2003 botohen veprat e Pedersenit, Zajmit e Hadrit dhe monografitë e M. Berishës e S. Hamitit. Tani nis për herë të parë veprimtaria në hartimin e fjalorëve terminologjikë, këtë radhë botohet *Fjalori i emrave të bimëve* dhe *Fjalori i terminologjisë së botanikës*, të dy bashkë me ASHSH-në në një vëllim shumë të gjerë dhe në disa gjuhë. Në vitin 2003 rifilloi botimi i *Vjetarit* të ASHAK-ut për vitet e mbetura, për të vazhduar me rregull. Viti 2004 shënon një cilësi të re në botimet e veçanta me veprat e B. Bokshit, E. Berishës, P. Nushit, u vazhdua seria *Vepra* të Zajmit, Rizës, Cimochofski-t (shqip), Pedersen-it (shqip), ndërsa si botim kolektiv doli vetëm *Kosova dhe statusi i saj i ardhshëm – aspekte e këndkundraime, Statusi i ardhshëm i Kosovës*, ku përfshiheshin materialet e tubimeve shkencore me këto tema. Po atë vit u botua vepra e rëndësishme (mbi 800 faqe) e albanologut gjerman W. Fiedler për sistemin foljor në gjuhën e “Mesharit” të Gjon Buzukut në gjuhën gjermane, që mund të konsiderohet një ndërmarrje e veçantë për albanistikën.



*Selia e vjetër e ASHAK-ut*

Në vitin 2005 ASHAK-u arriti rekordin e saj të derisotëm me botimet. Përveç revistave, që dolën me rregull, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë botoi veprat e: B. Bokshit, A. Aliut, R. Ismajlit, S. Hamitit, hartoi dhe botoi fjalorin e gjerë të terminologjisë së informatikës me autorët N. Caka & A. Dika & S. Rodiqi, veprën kolektive *Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare*; në Seksionin e Shkencave Shoqërore veprat e H. Islamit, M. Kullashit, E. Stavilecit, M. Krasniqit, J. Rexhepagiqit; në Seksionin e Shkencave të Natyrës veprat e M. Dushit e L. Susurit; në Seksionin e Arteve veprat e R. Dhomit, T. Emrës, dhe në Kryesi veprat: *30 vjet të ASHAK, Artistët akademikë, Aktet e Kuvendit të Kosovës, Kosova shtet i pavarur dhe sovran*.

Vitet në vijim po ashtu kanë shënuar rritje të sasisë dhe të cilësisë së botimeve të Akademisë, qoftë në saje të ndërmarrjeve të veçanta botuese, qoftë edhe falë konferencave e tubimeve shkencore të mbajtura ndërkohë, materialet e të cilave duheshin botuar. Revistat tashmë janë vënë në rend të botimit brenda vitit, ndërsa materialet e konferencave dhe të tubimeve shkencore po ashtu shpejt pas mbajtjes së tubimit. Në vitin 2006 Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë botoi 3 vepra të natyrës filologjike-kritike: *Poezitë* e P. Budit (R. Ismajli), monografinë për Gj. Nikollë Kazazin bashkë me botimin kritik të Doktrinës së tij (B. Demiraj), veprën e G. Darës I Riu (Sh. Demiraj),

pastaj vëllimin e I. Ajetit, *Për të vërtetën shkencore* dhe kolanën me poezi të përzgjedhura të shoqëruara me *Parathënie* e shënime të poetëve anëtarë të Akademisë – E. Mekuli, E. Gjerqeku, B. Bokshi, A. Podrimja, E. Basha, S. Hamiti, ndërsa në Seksionin e Shkencave Shoqërore do veçuar monografia *Banesa qytetare e Kosovës* (sh. XVIII-XIX) nga E. Riza e Nj. Haliti. Po atë vit u shënua botimi i veprës së zgjedhur të Aleks Budës dhe, si botim i Akademisë në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës, *Hartës arkeologjike të Kosovës*. Pos *Studime* 13, *Vjetari* 26 e 27, *Kërkime* 14 e *Botimet e ASHAK-ut*, dolën dhe materialet e tubimeve shkencore: për Faik Konicën dhe për Kosovën shtet i pavarur e sovran. Në vitin 2007 kemi botime të rëndësishme në fushat filologjike-gjuhësore: botohet e plotë shqip dhe gjermanisht vepra albanistike e Franc Miklošič-it, duke shënuar kështu dhe bashkëpunimin e parë konkret me Akademinë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve, përmblihet nga revistat e shpërndara nëpër botë, përkthehet dhe botohet për herë të parë shqip vepra e albanologut më të madh amerikan E. P. Hamp dhe monografia gjermanisht për *Formimin e shumësit në gjuhën shqipe* e W. Fiedler-it, e shoqëruar me 80 harta dialektore, të realizuara brenda Akademisë. Të gjitha këto vepra hyjnë në fondin themelor albanistik. Në serinë e veprave të përzgjedhura të anëtarëve të Akademisë u botua përzgjedhja e gjerë *Kritika* e I. Rugovës, ndërsa në Seksionin e Shkencave Shoqërore një vepër e E. Stavilecit, pastaj katalogu i madh i R. Ferrit në Seksionin e Arteve dhe revistat. Po këto rrjedha vijojnë në vitin 2008, që shënohet me botimin e veprave të veçanta të Ch. Gut për V. Pashën, A. Aliut me studime letrare dhe të veprës së përzgjedhur të albanologut E. Çabej me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij, ku përfshihen veprat e tij themelore. Në Seksionin e Shkencave Shoqërore këtë herë dalin vepra të H. Islamit, J. Rexhepagiqit, M. Kullashit, P. Nushit, E. Stavilecit, E. Murtezait dhe përzgjedhja e gjerë e *Veprave sociologjike e politologjike* të F. Aganit. U botuan materialet e *Konferencave shkencore për Filologjinë shqiptare*, për Mitrush Kutelin dhe për Mjedisin e Kosovës.

Botimet paraqesin një nga format e rëndësishme të punës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Në fillimet e saj ASHAK-u përballej me vështirësi të natyrave të ndryshme në këtë drejtim: duke filluar nga standardet dhe orientimet që vendoseshin në rrafshin e akademive të Jugosllavisë e deri te nevoja për t'i bërë të qarta relatat ideologjike në rrafshin e përbashkët për tërë shtetin dhe në rrafshin e veçantë për shqiptarët. Në atë periudhë më të shpeshta ishin botimet serbokroatisht dhe për probleme shpesh jotipike dhe jorelevante për Kosovën. Në vitet '90 u

bë kthesë në këtë drejtim dhe, përveç veprave më të shumta të autorëve vendorë, nisën të botoheshin dhe seri me vlerë për tërë kulturën shqiptare, si kolana e Veprave të albanologëve të traditës. Në këtë kolanë deri tash janë përfshirë veprat e S. Rizës (5 vëllime), të I. Ajetit (5 vëllime), të W. Cimochowski-t (një vëllim), të H. Pedersen-it (një vëllim), të F. Miklošič-it, të E. P. Hamp-it, pastaj të G. Zajmit (4 vëllime), vepra të zgjedhura të A. Hadrit (një vëllim), të A. Budës (1 vëllim), të F. Aganit (1 vëllim), të E. Çabejtë (1 vëllim), të I. Rugovës (1 vëllim), të W. Fiedler-it (2 vëllime), të F. Altimarit, të L. Savoia-s, të N. Jokl-it, të R. Nahtigalit, etj., çka në tërësi tashmë paraqet një korpus me vlerë, ndërsa së shpejti pritet të dalin dhe vepra të albanologëve të tjerë.

Njëkohësisht ka ardhur duke u zgjeruar veprimtaria botuese dhe dokumentare. Në këtë kohë u botuan dhe vijnë të botohen vepra me vlerë në fushat filologjike (Fiedler, Miklošič, Hamp, Rugova, Çabej, Gut, Aliu, Halimi, materialet e konferencave për Studimet filologjike, për M. Kutelin; në fushat e shkencave shoqërore (Stavileci, Krasniqi, materialet e konferencës për Veqilharxhin, Gyt, Islami, Rexhepagiq, Kullashi, Agani, Nushi, Murtezai); në fushat e shkencave të natyrës (materialet e konferencës për mjedisin e Kosovës), po edhe në fushat e arteve (Ferri). Përveç veprave të sipërpërmendura në fushat e dijeve shoqërore, do të përmendim këtu veprat e N. Dacit, të M. Dushit, të M. Berishës, të L. Susurit, të H. Gashit dhe veprën e rëndësishme postume të D. Rozhajës në fushat e shkencave të natyrës, ashtu si dhe veprat muzikore të R. Dhomit, të Z. Ballatës, studimet muzikologjike të E. Berishës, katalogët me riprodhime të gjera të R. Ferrit, T. Emrës dhe sidomos monografitë e H. Muharremit për M. Mulliqin dhe të E. Bashës, A. Spahiut për A. Çavdarbashën, traditë që duhet të vazhdojë.

Në përgjithësi, periudha 2002-2008 është periudha më e frytshme e nismave me botime në tërë historinë e Akademisë deri në atë kohë, si sa i përket sasisë (ka po aq botime sa kishte në tërë periudhën e mëparme mbi 25-vjeçare), ashtu sa i përket cilësisë dhe orientimit. Në këtë periudhë janë shënuar dhe rezultate të tjera me rëndësi: janë intensifikuar tubimet shkencore, janë rritur bashkëpunimet me akademitë e tjera, është nxjerrë Ligji për Akademinë, i cili i siguron asaj pavarësinë si institucion publik i shkencës dhe i arteve, janë hartuar rregullimet e tjera administrative, është siguruar financimi nga Buxheti i Kosovës, vijoi projekti i botimit të veprave të albanologëve të traditës, sidomos të albanologëve të huaj të përkthyer shqip dhe e tërë veprimtaria u kthye në binarë normalë të funk-

sionimit sipas uzuseve dhe nevojave të vendit, dhe nisi cikli i investimeve kapitale: u nxor vendimi për ndërtimin e godinës së re të Akademisë dhe nisi procesi i ndërtimit, që do të përfundojë më 2010. Në aspektin e punës së Akademisë ka pasur dhe risi të tjera, si për shembull zgjerimi i punës së komisioneve, themelimi i Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe bashkë me ASHSH-në, përpjekjet për hartimin e Historisë shqiptare bashkë me ASHSH-në, intensifikimi i punës në fjalorët terminologjikë dhe nisma për hartimin e enciklopedisë shqiptare.

Në periudhën 2009-2011 në fushën e filologjisë u botuan veprat e autorëve Ismajli, Riza, Hamiti, Bokshi, Jokl, materialet e konferencave për historinë e letërsisë, për studimet diakronike të shqipes; në fushat e shkencave shoqërore veprat e autorëve Krasniqi, Siqeca, Nushi, Stavileci, Përzhita, Mimoza Dushi; në fushat e shkencave matematike dhe të natyrës veprat e autorëve Gashi, Minir Dushi, Berisha-Berisha, materialet e konferencës për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore; në fushat e arteve botimet e veprave të Dhomit, të E. Berishës, të Ballatës, të Qëndros për Ferrin, ashtu si dhe numrat përkatës të revistave.

Vitet 2012-2014 kanë sjellë edhe më botime të reja të autorëve si Aliu, veprat e plota të Ali Podrimjes, V. Nuhiu, S. Hamiti, B. Bokshi, F. Altimari dhe botimet kolektive *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit* në fushat filologjike; të autorëve Islami, Kullashi, Ejupi, Osmani-Manaj, Bajrami, Shukriu, Berishaj, Nushi, dhe të veprave kolektive *Gërmime dhe studime arkeologjike 2000-2013, Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Kosovës* dhe të revistave; në fushat e shkencave të natyrës u botuan veprat e autorëve Dushi, Krasniqi, F., Daci-Daci-Ajvazi, Haxhibeqiri dhe veprat kolektive *Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm*, etj.; në fushën e arteve janë shënuar botimet e autorëve Ballata, Buza për T. Emrën, Emra, Varvarica-Kuka, etj. Në këtë periudhë është shënuar ndarja e revistës Studime në dy revista: *Studime – për filologji* dhe *Studime shoqërore*, botimi i *Kosova, vështrim monografik* shqip e anglisht, etj. Këto dy vite janë ndër më të suksesshmet. Në këtë periudhë u shënuan dhe botimet e para të Qendrës Leksikografike-Enciklopedike.

Viti 2015 ka nisur me botime serioze, po ashtu. Deri tash kanë dalë veprat e autorëve Islami-Ejupi, Dushi, Murtezai, Dhomi, Savoia, Nahtigal, Gashi, Altimari, Ismajli, Pllana, Ferri, botimet kolektive dhe edicione të tjera që vijojnë.

Mijëvjeçari i ri filloi në rrethana të reja, me mundësi të reja, pa kon-



trollet dhe survejimet e mëparme, por me trashëgimi të reduktuar sa i përket anëtarësisë dhe me kufizim të natyrës financiare e materiale, në një anë, dhe me pasojat që kishte lënë jeta e vështirë nën shtypjen e rëndë të viteve '90, shpërnguljet dhe lufta. Në këtë kohë ASHAK-u i rimori këto veprimtari me këmbëngulje dhe e zgjeroi veprimtarinë botuese në të gjitha drejtimet. Në vitet 2005-2006 ajo shënoi rritjen e madhe të botimeve, ndërsa në vijim ngul këmbë në e cilësisë dhe botimin në radhë të parë të veprave të krijuara në Akademi.

Në periudhën 2008-2011 vijuan tendencat e nisura më herët për intensifikimin e botimeve në rrethana të reja me hapësira të mjaftueshme pune në godinën që u përfundua. U intensifikuan po ashtu veprimtaritë shkencore si simpoziumet, tryezat dhe konferencat, ekspozitat dhe koncertet, kontaktet dhe bashkëpunimi me akademitë e tjera. Në këtë periudhë dhe sidomos në periudhën në vijim 2012-2015 u përmirësua cilësia teknike e botimeve të Akademisë, u themelua Libraria e Akademisë dhe u reformua tërësisht administrata e saj. U themelua Komiteti i Kosovës për studime të Europës Juglindore, i cili u pranua anëtar me të drejta të barabarta në Komitetin Ndërkombëtar të Studimeve të Europës Juglindore. U mbajtën dhe u botuan materialet e konferencave të mëdha si Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Studimet albanistike në SHBA, diskutimet e gjera për çështje të ndryshme me aktualitet shoqëror, etj. U botua vepra kolektive *Kosova, vështrim monografik* – shqip e anglisht, u ndërmor projekti i madh *Fjalori enciklopedik i Kosovës*, që pritet të përfundojë në vitin në vijim, nisi realizimi i projektit *Shqipja e shkruar e sh. XX* dhe me këtë edhe procesi i themelimit të projektit *Korpusi kombëtar i shqipes*, për çka nevojiten investime shtesë dhe burime të reja financiare e njerëzore, etj.

Në periudhën 2000-2015 Akademia ia ka dalë të zgjeronte raportet e bashkëpunimit me akademitë e ndryshme europiane. Qysh më herët kishte vendosur marrëdhënie me Akademitë e Sllovenisë dhe të Kroacisë, ndërsa në vijim arriti marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë Mbretërore Belge Flamane, me Akademinë Italiane të 40-ve, me Akademinë Britanike, me Akademinë Austriake, me Akademinë Turke, me Akademinë Bullgare, me Akademinë e Maqedonisë, ndërsa ka vënë kontakte bashkëpunimi me Akademinë e Austrisë, me Akademinë e Goettingenit, me Akademinë Frënge (*Académie des inscriptions et belles lettres*), e me akademi të tjera. Me disa prej tyre kemi dhe rezultate bashkëpunimi konkret, si me Akademinë sllovene që deri tash kemi bërë 2 botime të përbashkëta.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar qysh më 2004 ASHAK-u është pranuar anëtare me të drejta të plota e ALLEA-s – Federata e akademive nacionale të Europës, më 2000 është bashkëthemeluese e Unionit të Akademive të Europës Juglindore, është anëtare në Interacademic Panel (IAP), merr pjesë aktive në Unionin e Akademive të Europës Qendrore, ndërsa është anëtare e Interacademic Human Rights Network me seli në New York.

Me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë ASHAK-u ka marrëdhënie të posaçme qysh më herët. Në vitin 2000 e ka përtërirë marrëveshjen e bashkëpunimit në bazë të protokolleve të firmosura përkrye dy vjetësh. Ky bashkëpunim shtrihet në shkëmbim përvojash, në programe të përbashkëta pune, si konferenca shkencore, botime të përbashkëta, projekte të përbashkëta si Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, etj. Nga viti 2015 ASHAK-u përmes Komitetit të Kosovës për Studime të Europës Juglindore është anëtare e Asociacionit të Studimeve të Europës Juglindore që vepron në kuadër të UNESCO-s.



*Logo e vjetër e ASHAK-ut*

Deri më 2004, kur Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e ri për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, ASHAK-u ka vepruar sipas Ligjit të miratuar nga Kuvendi i KSAK-së i vitit 1978 dhe tërë këtë kohë zyrtarisht ka pasur tjetër logo. Meqenëse kjo logo identifikohet me rendin e vjetër kushtetues e ligjor, ndërsa ASHAK-u vepron në kuadër të Republikës së Kosovës, shpalljen e mëvetësisë dhe të pavarësisë së cilës e kishte

mbështetur përmes Deklaratës Kushtetuese të vitit 1990 dhe përmes pjesëmarrjes aktive në të gjitha veprimtaritë e rëndësishme pastaj si 2 Korriku, Kushtetuta e Kaçanikut dhe lëvizjet e mëvona, kjo logo nuk u përdor më deri sa më 2004, me Ligjin e ri për Akademinë u bë e mundshme që përmes konkursit publik të zgjidhej logoja e re, që është kjo që kemi sot në fuqi. Me ligjin e vjetër Akademia ka pasur mundësi të kishte institute, por në atë kohë nuk kishte rrethana për themelimin e tyre. Me ligjin ekzistues për Akademinë ASHAK-u nuk ka të drejtë të ketë institute dhe njësi shkencore-hulumtuese dhe kjo e ka prekur ndjeshëm këtë dimension të veprimtarive të saj. Sprova për ta shpërthyer këtë gjendje përmes themelimit të Qendrës Leksikografike-enciklopeditke deri tash ka funksionuar vetëm në segmentin e vullnetit të shfaqur brenda Akademisë, ndërsa përsa i përket buxhetit ka pasur mbështetje vetëm pjesërisht. Është financuar përmes buxhetit projekti i madh i kësaj Qendre – Fjalori enciklopedik i Kosovës, që funksionon si projekt më vete, ndërsa Qendra ende nuk është funksionalizuar. Nuk janë gjetur burimet as për projektin tjetër të madh – Korpusi kombëtar i shqipes, ashtu si as për projektin tjetër Shqipja e shkruar e sh. XX, pjesë të të cilit po realizohen nga burimet e brendshme të ASHAK-ut. Por Qendra si institucion me drejtim dhe program të pavarur pune e buxhet të saj ende nuk është funksionalizuar. Kjo, natyrisht, do të kërkonte dhe investime më substanciale, për të cilat pritet që shoqëria e Kosovës të bëjë hapa të tjerë. Zhvillime të tilla priten në të ardhmen.

Për fat të keq, ajo deri sot nuk ka arritur që paralelisht me rritjen e botimeve të ndërmarrë dhe hapa përkatës për shpërndarjen dhe plasimin e tyre në treg, çka do ta ndihmonte pastaj sërish këtë veprimtari. Na mban shpresa se në një të ardhme të afërt mund të ndërmerret ndonjë hap me vlerë në këtë drejtim dhe kjo rrjedhë pozitive do të vazhdojë.

Rexhep Ismajli



## THE ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS OF KOSOVA

The first organised interest in scientific research work in Kosova in the 20<sup>th</sup> century was related to laic education.

After the Second World War, these developments passed through four phases that were determined by socio-political events of the time.

Phase I (1945-1966) was characterised with confusing developments and so initiatives were by the wayside. Some activities of practical nature were undertaken, some within the framework of the Kosova Museum. The attempt made with the Albanologic Institute in 1953 was stopped in 1955, and in 1958 the Higher Administrative School and Higher Pedagogical School were opened in Prishtina, although with domination of the Serbian language. In 1960, the Faculty of Philosophy and in 1962 the Faculty of Law & Economics were founded as branches of the University of Belgrade. Instruction was in Serbian, apart from the Department of Albanian Language and Literature which taught in Albanian.

Phase II (1967-1980) was characteristic for increased requirements for the development in the field of education in Albanian, and also for the development in the field of scientific-research activity. In this period, the network of scientific-research institutions branched out up to the Academy of Sciences and Arts of Kosova. Also, the Provincial Association of Scientific Activity was founded to support the research activities with their budget in this field.

Phase III (1981-1990) was characteristic of general pressure against the scientific and education institutions in Kosova.

Phase IV (1990-1999) was characteristic of extinction of the Kosova autonomy, expulsion of Albanians from the education and scientific insti-

tutions, the stopping financing the independent scientific institutions, which were proclaimed closed by the Serbian state, together with the scientific-education institutions acting within the framework of economy due to the robbery ruling, etc. In this phase, the survival of the university education continued in the entire parallel system and outside university environments thus forcing the reorganisation of Kosova institutions for their own survival.

Phase V (2000 onwards) has been characteristic of relatively low development of institutions. The Academy of Sciences and Arts of Kosova, the Albanologic Institute in Prishtina, the Kosova Institute of History, the Institute of Economics and the University survived in financially difficult circumstances. In the period from 2000 to 2003, everything was concentrated in an international direction, which had other priorities. Following 2004, the activity of scientific independent institutions was put under the umbrella of the Ministry of Education, Science and Technology (MEST). Only after 2004, were legal regulations made possible, which returned the position of the Academy to a specific budget agency.

In more recent developments, in 2003, the Ministry of Culture founded the Institute of Archaeology. In 2008, the Assembly of the Republic of Kosova established the National Council of Science, the first duty of which was of drafting a scientific developing strategy for the next five years.

The Academy of Sciences and Arts of Kosova (ASAK) was founded as an Association of the Sciences and Arts of Kosova in Prishtina in 1975. It developed into the Academy of Sciences and Arts of Kosova by the Law of the Assembly of the Socialist Autonomous Province of Kosova in 1978, thus becoming the highest institution of sciences and arts in Kosova. Its members are scientists, scholars and artists, who are known for their achievements. Through its activity, the ASAK is obliged to instigate and promote the development of scientific thought. Furthermore, it aims to stimulate creativity in arts by developing direct activities in respective fields as well as organising research work in different fields of sciences and arts.

In the beginning, the ASAK had three sections, and in 1994 it

branched out into these four sections: the Section of Linguistics and Literature, the Section of Social Sciences, the Section of Natural Sciences, and the Section of Arts. The Academy has its administration unit, library, and archives.

In discussing the constitutional changes in 1989, the Assembly of the ASAK performed its public engagement with the *Constitutional Declaration*, by engaging in favour of protection of the rights that were violated.

In 1992, the Parliament of Serbia, by the Law on the Serbian Academy of Sciences and Arts proclaimed the ASAK to be closed down. The ASAK members did not accept it. In 1994, the Serbian police closed the building of the ASAK, but it continued acting in private premises in Prishtina.

Currently, the ASAK publishes these contemporary journals: *Studime* (Studies), in the fields of philology and social sciences; *Kërkime* (Researches), with contributions in the field of social sciences; *Vjetari* (Annual), and the continuation of *Vjetari – Godišnjak* of 1976. In earlier times, the ASAK published the following: *Studime – Studije* (Studies); *Kërkime – Istraživanja* (Researches), *Social Sciences*; *Kërkime – Istraživanja* (Researches), *Natural Sciences*. As of 1976 through to 1989, the KASA, in co-operation with the Association for Biology and Experimental Medicine of Kosova, published the review with an international index called *Acta biologiae et medicinae experimentalis*. Furthermore, the ASAK has also founded the Encyclopaedic-Lexicographic Centre, which is due to become functional. After 2012 the journal *Studime (Studies)* was reserved for philological issues, while a new series *Studime shoqërore (Social studies)* has been created.

In the period from 1970 to 1980, the ASAK developed its international activity through the Union of the Yugoslav Academies. In the 1990's, ASAK established relations with various foreign academies, including the following: the Academies of Sciences of Albania Croatia, and Slovenia as well as with the Academy of Sciences Delta Dei Quaranti of Italy, the Austrian Academy of Sciences, the Belgium Royal Flammish Academy, the British Academy, and the Turkish Academy. In 2002, ASAK became a member of the Union of the South-East European

Academies; from 2004, it became a member of the Federation of National Academies of Europe (ALLEA), and from 2006, it became a member of the International Academic Panel (IAP).

Rexhep Ismajli



**KRYESITË E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË  
ARTEVE TË KOSOVËS  
THE PRESIDENCIES OF THE KOSOVA ACADEMY  
OF SCIENCES AND ARTS**

**1. Kryesia e Shoqatës/ Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të  
Kosovës (20.12.1975 – 29.1.1979)  
Presidency of the Association/ Academy of Sciences and Arts of  
Kosova (20.12.1975 – 29.1.1979)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Esad Mekuli  
Nënkryetarë/ Vice presidents: akademik/ academician Idriz Ajeti dhe/ and  
akademik/ academician Vukašin Filipović  
Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Jashar  
Rexhepagiq  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of  
Social Sciences: akademik/ academician Syrja Pupovci  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of  
Natural Sciences: akademik/ academician Ljubiša Rakić  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the  
Section of Literature and Arts: akademik/ academician Rexhep Qosja.

**2. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA  
(29.1.1979 – 11.5.1982)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Idriz Ajeti  
Nënkryetarë/ Vicepresidents: akademik/ academician Dervish Rozhaja dhe  
akademik/ academician Vukašin Filipović (nga 11.7.1981)  
Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Syrja  
Pupovci  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of

Social Sciences: akademik/ academician Ali Hadri  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Ljubiša Rakić  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the Section of Literature and Arts: akademik/ academician Rexhep Qosja.

### **3. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (11.5.1982 – 10.5.1984)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Dervish Rozhaja  
Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Vukašin Filipović  
Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Syrja Pupovci  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: anëtari korrespondent/ corresponding member Osman Imami  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the Section of Literature and Arts: anëtari korrespondent/ corresponding member Vladeta Vuković

### **4. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (10.5.1984 – 9.5.1986)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Syrja Pupovci  
Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq  
Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: anëtari korrespondent/ corresponding member Vladeta Vuković  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: anëtari korrespondent/ corresponding member Božidar Jovanović  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Minir Dushi  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the Section of Literature and Arts: anëtari korrespondent/ corresponding member Muslim Mulliqi

## **5. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (9.5.1986 – 17.5.1988)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Vukašin Filipović  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Muslim Mulliqi  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Osman Imami  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Musa Haxhiu  
 Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the Section of Literature and Arts: akademik/ academician Svetomir Arsić

## **6. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (17.5.1988 – 24.5.1990)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Vukašin Filipović  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Muslim Mulliqi  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Osman Imami  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Musa Haxhiu  
 Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the Section of Literature and Arts: akademik/ academician Svetomir Arsić

## **7. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (24.5.1990 – 4.6.1992)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Musa Haxhiu  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Mark Krasniqi  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Dragoslav Pejčinović  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Gazmend Zajmi  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: anëtari korrespondent/ corresponding member Remzi Bakalli

Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the Section of Literature and Arts: akademik/ academician Vladeta Vuković

## **8. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (4.6.1992 – 30.6.1994)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Mark Krasniqi (nga 27.6.1993  
akademik/ academician Gazmend Zajmi)

Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Gazmend Zajmi (deri  
më 27.6. 1993)

Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Minir  
Dushi

Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of  
Social Sciences: anëtari korrespondent/ corresponding member Zef  
Mirdita

Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of  
Natural Sciences: akademik/ academician Dervish Rozhaja

Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve/ Secretary of the  
Section of Literature and Arts: akademik/ academician Enver Gjerqeku.

## **9. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (30.6.1994 – 9.7.1996)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Gazmend Zajmi (nga  
25.5.1995- akademik/ academician Idriz Ajeti)

Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Idriz Ajeti (deri më  
25.5.1995)

Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: anëtari korrespondent/  
corresponding member Nexhat Daci

Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of  
Social Sciences: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq

Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of  
Natural Sciences: akademik/ academician Dervish Rozhaja

Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section  
of Language and Literature: anëtari korrespondent/ corresponding  
member Rexhep Ismajli

Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: anëtari  
korrespondent/ corresponding member Rauf Dhomi.

**10. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA  
(9.7.1996 – 8.11.1999)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Idriz Ajeti  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Muslim Mulliqi  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: anëtari korrespondent/ corresponding member (nga 24.12.1996) akademik/ academician Nexhat Daci  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Minir Dushi  
 Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section of Language and Literature: anëtari korrespondent/ corresponding member (nga 24.12.1996) akademik/ academician Rexhep Ismajli  
 Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: anëtari korrespondent/ corresponding member (nga 24.12.1996) akademik/ academician Rexhep Ferri

**11. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA  
(8.11.1999 – 30.11.2002)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Nexhat Daci  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Jashar Rexhepagiq  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Rexhep Ismajli  
 Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section of Language and Literature: akademik/ academician Enver Gjerqeku  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: anëtari korrespondent/ corresponding member (nga 20.12.2000) akademik/ academician Hivzi Islami  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Minir Dushi  
 Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: akademik/ academician Rexhep Ferri

**12. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA  
(30.11.2002 – 30.11. 2005)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Rexhep Ismajli

Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Besim Bokshi  
Sekretar i përgjithshëm/ Secretary general: akademik/ academician Hivzi Islami  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section of Language and Literature: akademik/ academician Eqrem Basha  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Ekrem Murtezai  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Muharrem Berisha  
Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: akademik/ academician Rauf Dhomi.

### **13. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (30.11.2005– 30.11.2008)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Rexhep Ismajli  
Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Besim Bokshi  
Sekretar i Përgjithshëm: akademik/ academician Hivzi Islami  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section of Language and Literature: akademik/ academician Eqrem Basha  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Ekrem Murtezai  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of Natural Sciences: akademik/ academician Muharrem Berisha  
Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: akademik/ academician Rauf Dhomi.

### **14. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA (30.11.2008– 29.11.2011)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Besim Bokshi  
Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Hivzi Islami  
Sekretar i përgjithshëm/ Secretary general: akademik/ academician Engjëll Berisha  
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section of Language and Literature: akademik/ academician Mehmet Kraja  
Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of Social Sciences: akademik/ academician Pajazit Nushi  
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of

Natural Sciences: akademik/ academician Latif Susuri  
 Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: akademik/  
 academician Tahir Emra

**15. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA  
 (30.11.2011– 24.12. 2014)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Hivzi Islami  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Pajazit Nushi  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Isuf  
 Krasniqi  
 Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section  
 of Language and Literature: akademik/ academician Mehmet Kraja  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore/ Secretary of the Section of  
 Social Sciences: akademik/ academician Mark Krasniqi  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of  
 Natural Sciences: akademik/ academician Fejzullah Krasniqi  
 Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: akademik/  
 academician Zeqirija Ballata

**16. Kryesia e ASHAK-ut/ Presidency of KASA  
 (24.12. 2014)**

Kryetar/ President: akademik/ academician Hivzi Islami  
 Nënkryetar/ Vice President: akademik/ academician Pajazit Nushi  
 Sekretar i përgjithshëm/ Secretary generall: akademik/ academician Isuf  
 Krasniqi  
 Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë/ Secretary of the Section  
 of Language and Literature: akademik/ academician Eqrem Basha  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore: akademik/ academician Jusuf  
 Bajraktari  
 Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës/ Secretary of the Section of  
 Natural Sciences: akademik/ academician Fejzullah Krasniqi  
 Sekretar i Seksionit të Arteve/ Secretary of the Section of Arts: anëtari  
 korrespondent/ corresponding member Luan Mulliqi

**KRYETARËT E AKADEMISË SË SHKENCAVE  
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS  
PRESIDENTS OF THE KOSOVA ACADEMY  
OF SCIENCES AND ARTS**



Esad Mekuli 1975-1979



Idriz Ajeti 1979-1982 1995-1999



Dervish Rozhaja 1982-1984



Syrja Pupovci 1984-1986



Vukašin Filipović 1986-1988 1988-1990



Musa Haxhiu 1990-1992






Mark Krasniqi 1992-1994




Gazmend Zajmi 1994-1996



Nexhat Daci 1999-2002



Rexhep Ismajli 2002-2005 2005-2008



Besim Bokshi 2008-2011



Hivzi Islami 2011-2014 2014-



## ANËTARËT/ MEMBERS

### SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË SECTION OF LANGUAGE AND LITERATURE

#### *Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

Akademik/ academician **Ali Aliu** (1934), i zgjedhur më/ elected in 2000 (1996).•

Akademik/ academician **Eqrem Basha** (1948), i zgjedhur më/ elected in vitin 2004 (2000).

Akademik/ academician **Idriz Ajeti** (1917), i zgjedhur më/ elected in 1975.

Akademik/ academician **Rexhep Ismajli** (1947), i zgjedhur më/ elected in 1996(1993).

Akademik/ academician **Rexhep Qosja** (1936), i zgjedhur më/ elected in 1975.

Akademik/ academician **Mehmet Kraja** (1952), i zgjedhur më/ elected in 2008 (2004).

Akademik/ academician **Sabri Hamiti** (1950), i zgjedhur më/ elected in 2008 (2000)

#### *Anëtarë korrespondentë/Corresponding members:*

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Mehmet Halimi** (1937), i zgjedhur më/ elected in 2012.

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Zejnullah Rrahmani** (1952), i zgjedhur më/ elected in 2012.

---

• Në kllapa është viti i pranimit në Akademi si anëtar korrespondent/ in parantheses the year of election as corresponding member.

## In memoriam

### *Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

- Akademik/ academician **Ali Podrimja** (1942), i zgjedhur më/ elected in 2000 (1996).
- Akademik/ academician **Enver Gjerqeku** (1928), i zgjedhur më/ elected in 1991 (1986).
- Akademik/ academician **Esad Mekuli** (1916-1993), i zgjedhur më/ elected in 1975.
- Akademik/ academician **Besim Bokshi** (1930), i zgjedhur më/ elected in 1996 (1991).
- Akademik/ academician **Vukašin Filipović** (1930), i zgjedhur më/ elected in 1975.
- Akademik/ academician **Vladeta Vuković** (1928), i zgjedhur më/ elected in 1985 (1979).

### *Anëtarë korrespondent/ Corresponding members:*

- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Anton Pashku** (1937-1995), i zgjedhur më/ elected in 1993.
- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Ibrahim Rugova** (1944-2006), i zgjedhur më/ elected in 1996.

## SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

### *Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

- Akademik/ academician **Ekrem Murtezai** (1931) i zgjedhur më/ elected in 2000 (1996).
- Akademik/ academician **Hivzi Islami** (1946), i zgjedhur më/ elected in 2000 (1996).
- Akademik/ academician **Isa Mustafa** (1951), i zgjedhur më/ elected in 2012 (2008).

### *Anëtarë korrespondentë/ Corresponding members:*

- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Anton K. Berishaj** (1954), i zgjedhur më/ elected in 2012.
- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Arsim Bajrami** (1960), i zgjedhur më/ elected in 2012.

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Edi Shukriu** (1950) e zgjedhur më/ elected in 2012.

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Jusuf Bajraktari** (1948), i zgjedhur më/ elected in 2012.

*Anëtarë jashtë trupit të përhershëm të punës/ Members outside of the permanent working body:*

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Zef Mirdita** (1936), i zgjedhur më/ elected in 1991.

### In memoriam

*Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

Akademik/ academician **Ali Hadri** (1931-1987), i zgjedhur më/ elected in 1975.

Akademik/ academician **Božidar Jovanović** (1926), i zgjedhur më/ elected in 1986 (1983).

Akademik/ academician **Esat Stavileci** (1942-2015), i zgjedhur më/ elected in 2000 (1996).

Akademik/ academician **Fehmi Agani** (1932-1999), i zgjedhur më/ elected in 1993 (1996).

Akademik/ academician **Gazmend Zajmi** (1936-1995), i zgjedhur më/ elected in 1975.

Akademik/ academician **Jashar Rexhepagiq** (1929-2010), i zgjedhur më/ elected in 1975.

Akademik/ academician **Mark Krasniqi** (1920-2015), i zgjedhur më/ elected in 1985 (1979).

Akademik/ academician **Pajazit Nushi** (1933-2015), i zgjedhur më/ elected in 2008 (2000).

Akademik/ academician **Syrja Pupovci** (1937-1998), i zgjedhur më/ elected in 1975.

*Anëtarë korrespondentë/ Corresponding members:*

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Hajredin Hoxha** (1926-1987), i zgjedhur më/ elected in 1979.

## SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

### *Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

- Akademik/ academician **Feriz Krasniqi** (1931), i zgjedhur më/ elected in 2000 (1996).
- Akademik/ academician **Minir Dushi** (1929), i zgjedhur më/ elected in 1979 (1975).
- Akademik/ academician **Nexhat Daci** (1944), i zgjedhur më/ elected in 1996 (1993).
- Akademik/ academician **Latif Susuri** (1941), i zgjedhur më/ elected in 2008 (2000).
- Akademik/ academician **Isuf Krasniqi** (1948) i zgjedhur më/ elected in 2012 (2008).
- Akademik/ academician **Fejzullah Krasniqi** (1953) i zgjedhur më/ elected in 2012 (2008)

### *Anëtarët korrespondentë/ Corresponding members:*

- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Arsim Morina** (1956), i zgjedhur më/ elected in 2012.
- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Qamil Haxhibeqiri** (1949) i zgjedhur më/ elected in 2012.
- Anëtari korrespondent/ corresponding member **Salih Gashi** (1944), i zgjedhur më/ elected in 2012.

### *Anëtarë jashtë trupit të përhershëm të punës/ Members outside of the permanent working body:*

- Akademik/ academician **Dragoslav Pejčinović** (1932), i zgjedhur më/ elected in 1991 (1986).
- Akademik/ academician **Ljubiša Rakić** (1931), i zgjedhur më/ elected in 1975.

## In memoriam

### *Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

- Akademik/ academician **Dervish Rozhaja** (1934-1996), i zgjedhur më/ elected in 1975.

Akademik/ academician **Muharrem Berisha** (1942-2010), i zgjedhur më/  
elected in 2000 (1996).

Akademik/ academician **Musa Haxhiu** (1939-2006), i zgjedhur më/  
elected in 1983 (1979) (jashtë përbërjes së punës nga viti 1992).

Akademik/ academician **Osman Imami** (1936-1996), i zgjedhur më/  
elected in 1979 (1985).

Akademik/ academician **Remzi Bakalli** (1944-2007), i zgjedhur më/  
elected in 1991 (1986) (jashtë përbërjes së punës nga viti 1992).

*Anëtarë korrespondentë/ Corresponding members:*

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Eshref Ademaj** (1940-  
1994), i zgjedhur më/ elected in 1993.

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Ruzhdi Pllana** (1940-  
2015), i zgjedhur më/ elected in 2012.

## SEKSIONI I ARTEVE

*Anëtarët e rregullt:*

Akademik/ academician **Rauf Dhomi** (1945), i zgjedhur më 1996 (1993)

Akademik/ academician **Rexhep Ferri** (1937), i zgjedhur më/ elected in  
2000 (1996)

Akademik/ academician **Zeqirja Ballata** (1943), i zgjedhur më/ elected in  
2000 (1996)

Akademik/ academician **Tahir Emra** (1938), i zgjedhur më/ elected in  
2008 (2000)

*Anëtarët korrespondentë:*

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Xhevdet Xhafa**  
(1934), i zgjedhur më/ elected in 2012.

Anëtari korrespondent/ corresponding member **Luan Mulliqi** (1953),  
i zgjedhur më/ elected in 2012.

*Anëtarë jashtë trupit të përhershëm të punës/ Members outside of the  
permanent working body:*

Akademik/ academician **Svetomir Arsić** (1928), i zgjedhur më/  
elected in 1983 (1986).

## In memoriam

### *Anëtarë të rregullt/ Regular members:*

Akademik/ academician **Agim Çavdarbasha** (1944-1999), i gjedhur më 1993 (1996).

Akademik/ academician **Muslim Mulliqi** (1934-1998), i zgjedhur më/ elected in 1979 (1985).

Akademik/ academician **Engjëll Berisha** (1934), i zgjedhur më/ elected in 2008 (2000).

### ANËTARË TË JASHTËM/ EXTERNAL MEMBERS

**Branko Pavićević** (histori/ history), CANU, Mali i Zi/ Montenegro, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Dragiša Ivanović** (fizikë), CANU, Mali I Zi/ Montenegro, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Dušan Kanazir** (biokimi/ biochemistry), SANU, Serbi/ Serbia, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Ed-hem Čamo** (veterinë/ veterinary), ANU BiH/ Bosnia and Herzegovina, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Grga Novak** (histori/ history), JAZU, Kroaci/ Croatia, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Janez Milčinski** (mjekësi ligjore/ legal medicine), SAZU, Slloveni/ Slovenia, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Mihajlo Apastolski** (histori/history), MANU, Maqedoni/ Macedonia, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Pavle Savić** (fizikë/ physics), SANU, Serbi/ Serbia, i zgjedhur më/ elected in 1976.

**Aleksandar Stipčević** (histori/ history), Kroaci/ Croatia, i zgjedhur më/ elected in 1983.

**Branislav Đurđev** (histori/ history), ANU BiH/ Bosnia and Herzegovina, i zgjedhur më/ elected in 1983.

**Ramiz Abdyli** (shkencat ushtarake/ military sciences; 1928-1996), Kroaci/ Croatia, zgjedhur më/ elected in 1983.

**Agnia S. Desnickaja** (gjuhësi/ linguistics), Rusi/ Russia, e zgjedhur më/ elected in 1991.

**Eric P. Hamp** (gjuhësi/ linguistics), SHBA/ USA, i zgjedhur më/ elected in 1991.



- Ismail Kadare** (letërsi/ literature), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 1991.
- Joseph Milie-Emili** (mjekësi/ medecine), Kanada/ Canada, i zgjedhur më/ elected in 1991.
- Kolë Popa** (kimi/ chemistry), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 1991.
- Neil S. Cherniack** (mjekësi/ medicine), SHBA/ USA, i zgjedhur më/ elected in 1991.
- Wilfried Fidler** (gjuhësi/ linguistics), Gjermani/ Germany, i zgjedhur më/ elected in 1991.
- Shaban Demiraj** (gjuhësi/ linguistics), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 1996.
- Gunnar Svane** (gjuhësilinguistics), Danimarkë/ Denmark, i zgjedhur më/ elected in 1996.
- Kristian Gyt** (histori e cultures/ history of culture), Francë/ France, i zgjedhur më/ elected in 1996.
- Çesk Zadeja** (muzikë/ musics), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 1996.
- Gjelosh Gjokaj** (art figurative/ fine arts), Gjermani/ Germany, i zgjedhur më/ elected in 1996.
- Leonard Newmark** (gjuhësi/ linguistics), SHBA/ USA, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Robert Elsie** (letërsi/ literature), Kanada/ Canada, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Michel Roux** (gjeografi, gjeopolitikë/ geography, geopolitics), Francë/ France, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Muhamedin Kullashi** (filozofi/ philosophy), Francë/ France, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Tomë Berisha** (elektroteknikë/ electroechnics), Kroaci/ Croatia, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Ibrahim Kodra** (art figurativ/ fine arts), Itali/ Italy, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Tish Dija** (muzikë/ musics), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 2000.
- Victor Friedman** (gjuhësi/ linguistics), SHBA? USA, i zgjedhur më/ elected in 2004.
- Noel Malcolm** (histori/history), Britania e Madhe/ Great Britain, i zgjedhur më/ elected in 2004.

**Emin Riza** (trashëgimi/ cultural inheritance), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 2008.

**Francesco Altimari** (gjuhësi/ linguistics), Kalabri, Itali/ Italy, i zgjedhur më/ elected in 2008.

**Muhamed Mufaku** (orientalist/ orientalistics), Jordani, i zgjedhur më/ elected in 2008.

**Alajdin Abazi** (shkencat teknike/ technical sciences), Maqedoni/ Macedonia, i zgjedhur më/ elected in 2012.

**Kolec Topalli** (gjuhësi/ linguistics), Shqipëri/ Albania, i zgjedhur më/ elected in 2012.

**Oliver Schmitt** (histori/ history), Austri(a), i zgjedhur më/ elected in 2012.

**Radoslav Katičić** (gjuhësi/ linguistics), Kroaci/ Croatia, i zgjedhur më/ elected in 2012.

#### ANËTARË NDERI

**Josip Broz Tito** (1892-1980), Kryetar i RSFJ-së, i zgjedhur më/ President of SFRY, elected in 1979.

**Nëna Tereze (Gonxhe Bojaxhiu)** (1910-1997), humaniste dhe nobeliste, e zgjedhur më/ humaniste and Nobel Prize, elected in 1990.

**Ferid Murad (1936 -)**, farmakologji/ pharmacology), nobelist, jeton në SHBA', i zgjedhur më/ Nobel prize, lives in USA, elected in 2000.

**BIOGRAFITË DHE BIBLIOGRAFITË  
E ANËTARËVE TË AKADEMISË  
BIOGRAPHIES AND BIBLIOGRAPHIES OF THE  
MEMBERS OF THE ACADEMY**

**ANËTARË TË RREGULLT  
REGULAR MEMBERS**

**SHËNIMI I REDAKSISË**

Shënimi i 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës po bëhet dhe përmes botimit të këtij vëllimi me shënimet për anëtarët e Akademisë dhe me bibliografinë e plotë të botimeve të Akademisë. Për këtë punë Kryesia e Akademisë para një kohe caktoi redaksinë, së cilës i dolën përpara shumë detyra, ndonjëherë të vështira për t'i përmbushur brenda afatit që kishte në dispozicion. Në këtë gjendje Redaksia vendosi të paraqiste shënimet e ofruara, ose ato që kishte në dispozicion shërbimi, por me ndonjë harmonizim të vogël. Kjo i shpjegon dallimet që mund të hetohen nga rasti në rast.



ALI ALIU

BIOGRAFIA

Lindi më 1934 në Kranjë të Prespës. Shkollën tetëvjeçare e filloi në vendlindje dhe e kreu në Manastir më 1951, ndërsa Shkollën Normale në Shkup më 1955. Studimet universitare (albanologji) i mbaroi në Beograd në vitin 1960. Pas studimeve zuri punë si gazetar në redaksinë “Flaka e vllaznimit” në Shkup. Prej vitit 1969 deri në vitin 1972 punoi redaktor në Edicionin e Botimeve “Rilindja” në Prishtinë. Doktoroi në Universitetin e Prishtinës më 1973 duke mbrojtur tezën “Jeta dhe vepra e Petro Markos”. Që nga viti 1972 deri në pensionim ishte ligjërues, docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, përkatësisht në Fakultetin Filologjik të Prishtinës, për lëndën Teori e letërsisë. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i saj. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.



Ali Aliu është studiues i letërsisë bashkëkohore shqiptare, fushë nga e cila ka botuar shumë vepra. Ka drejtuar disa kandidatë në tema magjistrature dhe doktorature. Ka shkruar dhe tekste shkollore për teorinë e letërsisë.

Ishte njëri nga themeluesit e LDK-së në vitin 1989 dhe anëtar i Kryesisë së saj në dy mandate, deri në vitin 1995. Ka drejtuar zyrën e Kosovës në Tiranë (1991).

Ka ligjëruar mbi 10 vjet si profesor në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Ali Aliu është bartës i disa mirënjohjeve, siç janë: Çmimi për librin më të mirë të vitit, Kritika letrare, botuar nga Sh.B. “Rilindja”; Çmimi “Dimitar Mitrev” të SHSHM për librin më të mirë me kritika Shtegtim metafore

për vitin 2007; Çmimin “Onufri” akorduar nga Festivali “Poeteka”, Durrës; Çmimi republikan “11 Tetori”; Çmimi “Krenaria e Prespës”, ndarë nga Shoqata “Prespa na bashkoi”, Çikago; Çmimin special për kritikë nga Shoqata e Shkrimtarëve Lezhianë, si dhe Çmimin “Azem Shkreli” për vepër jetësore në letërsi që ia ndau Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës në vitin 2015. është dekoruar ‘nderi i kombit’ nga Presidenti i Shqipërisë.

## BIBLIOGRAFIA

## Libra të botuar:

- Kërkime, Rilindja, Prishtinë, 1971.  
 Shqyrtime, Rilindja, Prishtinë, 1974.  
 Rrjedhave të letërsisë, Rilindja, Prishtinë, 1977.  
 Katër romane të Petro Markos, Flaka e vllaznimit, Shkup, 1974.  
 Kritika, Rilindja, Prishtinë, 1980.  
 Artikuj kritikë, Rilindja, Prishtinë, 1983.  
 Ese letrare, Rilindja, Prishtinë, 1987.  
 Kërkime, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.  
 Don Kishoti të shqiptarët, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1996.  
 Reflektse letrare, Flaka, Shkup, 1999.  
 Antologji e poezisë shqipe, Klubi letrar, Tetovë, 1999.  
 Antologji e poezisë shqipe, Albin, Tiranë, 2002.  
 Teoria e letërsisë, Enti i Teksteve Shkollore, Prishtinë, 1985.  
 Teori e letërsisë, (ribotim i plotësuar) Enti Shkollor, 2001 dhe Vatra, Shkup, 2002.  
 Antologji e poezisë shqipe, Klubi letrar - 94, Tetovë, 2000.  
 Antologji e poezisë shqipe, (ribotim i plotësuar), Albin, Tiranë, 2002.  
 Letërsia bashkëkohore shqiptare, koautor, për klasat e katërta të shkollave të mesme) Alb-ass, Tiranë - Tetovë, 2001; Libri Shkollor, Prishtinë më 2002.  
 Letërsi, koautor, për klasat e para të shkollave të mesme, Alb-ass Tiranë-Tetovë,  
 Kush do ta vrasë ujkun, tekst plus për maturantët: zgjedhje dhe analizë e poezisë së Ali Podrimjes, Alb-ass Tiranë, Tetovë dhe Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.  
 Si ta lexojmë poezinë?, Alb-ass, Tetovë-Tiranë, 2004.  
 Magjia e fjalës, Dukagjini, Pejë, 2003.  
 Kronika letrare, Logos, Shkup, 2003.  
 Vepra të zgjedhura, I, II, III, IV, Serembe, Shkup, 2004.  
 Don Kishoti shqiptar, ASHAK, Prishtinë, 2005.  
 Miti ballkanik të Kadareja, Onufri, Tiranë, 2007.  
 Fjalë për fjalën, Serembe, Shkup, 2008.  
 Dëshmi letrare, ASHAK, Prishtinë, 2008.  
 Shtegtimi i metaforës, Toena, Tiranë, 2009.  
 Don Kishoti shqiptar, Toena, Tioranë 2010.  
 Kënaqësia e leximit, ASHAK, Prishtinë, 2012.

## Maqedonisht:

- Don Kihotot medju albancite, Kultura, Skopje, 2004.  
 Antologjia na albanskata poezija (maqedonisht), Pro Littera, Shkup, 2004.  
 Skenderbeg (bashkë me Gane Todorovskin), ASHAM, Shkup, 2005.

## Bullgarisht:

- Don Kihotot meždu albancite, Blgarski pisatel, Sofija, 2008.

## Anglisht:

- Don Quixote among Albanians, St. Clement of Ohrid, National and University Library, Skopje, 2011.

## EKREM MURTEZAI

## BIOGRAFIA

Lindi më 1931 në Gjakovë. Rrjedh nga një familje qytetare, nga kanë dalë klerikë të fesë islame. Nga viti 1941 e deri në vitin 1948 vijoi mësimet në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Pas shtatë vjetëve, mu në pragun e ixhazetit, braktisi medresenë dhe në vitin 1948 u regjistrua në Shkollën Normale të Gjakovës, ndërsa në vitin 1951 u diplomua në Pejë. Pas një viti pune si arsimtar në Gjakovë, në vitin 1953 u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Beogradit – Dega e filozofisë. Studimet universitare i kreu më 1958. Ishte ndër shqiptarët e parë nga Kosova, që u diplomua në fushën e filozofisë. Gjatë viteve 1957-1963 ishte profesor i filozofisë dhe i gjuhës latine në gjimnazin “Hajdar Dushi” dhe i psikologjisë e i pedagogjisë në shkollën normale “Hysni Zajmi” të Gjakovës. Në vitet 1963-1969 ishte drejtor i gjimnazit “H. Dushi”. Nga 1969 e deri më 1973 punoi këshilltar i pavarur në Byronë Ekzekutive të Komitetit Qendror të LKJ dhe njëkohësisht shef i kabinetit të anëtarit të kësaj byroje – Fadil Hoxhës.



Studimet pasuniversitare i kreu në vitin 1972, në Fakultetin e Shkencave Politike të Beogradit. Në vitin 1973 u zgjodh ligjërues i lëndëve *Historia e filozofisë antike dhe mesjetare* dhe *Filozofisë marksiste*. U doktorua në vitin 1977 në Prishtinë me tezën “Lenini për logjikën dialektike”. Gjatë viteve 1983-1991 ishte profesor i rregullt i lëndëve të përmendura, por edhe i disa lëndëve të tjera filozofike: i estetikës, i logjikës, i idealizmit gjerman, i filozofisë bashkëkohore etj. Një kohë e ligjëroi edhe lëndën *Metodologjia dhe teknika e kërkimeve shkencore* në Degën e gjuhës dhe të letërsisë shqiptare. Disa herë u zgjodh shef i Degës filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Në vitin 1976 u bë laureat i Shpërblimit të Dhjetorit për shkencat shoqërore. Gjatë viteve 1973-1981 ishte drejtor i Qendrës Krahnore të Arsimit Marksist.



Anëtar korrespondent i ASHAK-ut që nga viti 1996, kurse në vitin 2000 u zgjodh anëtar i rregullt i kësaj akademie. Gjatë viteve 1983-1986 ishte kryetar i Shoqatës së Docentëve, Profesorëve dhe i Punëtorëve të tjerë Shkencorë të Kosovës.

## BIBLIOGRAFIA

## Librat e botuar:

- Filozofia materialiste-dialektike, QKAM, Prishtinë, 1975.  
 Studime filozofike, Rilindja, Prishtinë, 1975 dhe 1981.  
 Stalinizmi dhe neostalinizmi, QKAM, Prishtinë, 1976 dhe Rilindja 1981.  
 Pikëpamja e Leninit për metodën dialektike, QKAM, Prishtinë, 1976.  
 Marksizmi, socializmi dhe vetëqeverisja, QKAM, 1978 dhe Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1981.  
 Bazat e marksizmit (për kl. III dhe IV) së bashku me F. Aganin, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1980.  
 Bazat e marksizmit...(për kl. I), së bashku me F. Aganin, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1985.  
 Bazat e marksizmit...(kl. II), së bashku me B. Zhujën, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1986.  
 Filozofia (kl.IV gjimnaz), Enti i Teksteve, Prishtinë, 1989.  
 Hyrje në filozofi, Enti i Teksteve, Prishtinë, 1984.  
 Bazat e filozofisë marksiste (tekst universitar), Enti i Teksteve, Prishtinë, 1986.  
 Disa terma aktualë politikë (edhe serbokroatisht: Neki aktuelni politički termini Komunisti, Prishtinë, 1986.  
 Fjalori i filozofisë, Agjencia e Autorëve të Kosovës, Prishtinë, 1995.  
 Filozofia (për kl. IV gjimnaz), Enti i Teksteve të Kosovës, Prishtinë, 1996  
 Logjika, Enti i Teksteve të Kosovës, Prishtinë, 1997.  
 Leksikon i sentencave, citateve, sintagmave dhe proverbave latine, ASHAK, Prishtinë, 2008.  
 Fjalor i feve: sektet, rendet, bashkësitë, lëvizjet, doktrinat e fenomenet, Rilindja, Prishtinë, 2000.  
 Fjalor i terminologjisë fetare, Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, Prishtinë, 2007.  
 Fjalor i Filozofisë, Toena, Tiranë, 2007.  
 Hyrje konceptuale në filozofi, ASHAK, Prishtinë, 2015.

## Artikuj e shqyrtime:

- Fenomeni i tjetërsimit, Përparimi, vjeshtë e vitit 1960.  
 Ognjen Prica – filozof dhe revolucionar, Përparimi, 4/1961.  
 Empirizmi dhe racionalizmi – Buletini pedagogjik i Kosovës, 1963.  
 Lenini dhe leninizmi, Rilindja, 25.X-10.XI.1967.  
